

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5765
E martë, 30 prill 2019
çmimi 0.40 €

Mbi 245 mijë
lëndë presin zgjidhje
në gjykata



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR SAMITI I BERLINIT NË TË CILIN KANË MARRË PJESË LIDERËT
E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Merkeli dhe Macroni konfirmojnë angazhimin për një zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë



Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emanuel Macron kanë shprehur përkushtimin e tyre për zgjidhjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këtë zotim ata e kanë dhënë të hënën në kuadër të Samitit të Berlinit, në të cilin kanë pritur në takim të përbashkët liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Merkel me Macronin kanë bërë me dije se Gjermania dhe Franca do të angazhohen më shumë për stabilitetin dhe zhvillimin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, ata kanë thënë se zgjidhja e problemit në mes të Kosovës duhet të jetë në të mirë të gjithë rajonit. Sipas tyre, nuk mund të ketë marrëveshje, pasojat e së cilës mund t'i vuajnë vendet e tjera



AKTUALE

**GJUHA E
KOMUNIKIMIT
E SHQIPTARËVE
TË PARTIZUAR** F.8

Nga: Jakup KRASNIQI



**E KUNDËRTA E LUFTËS NUK
ËSHTË PAQJA, POR ARTI** F.6

Pal NDRECAJ, Nju Jork

EKONOMI

**TREGTIA PRIN PËR NUMRIN
E NDËRMARRJEVE TË
REGJISTRUARA** F.9

**BANKA BOTËRORE: ÇMIMET
E NAFTËS DO TË ULEN
GJATË VITEVE 2019-2020** F.9

EKONOMI

**'LIBRI I LUFTËS' VLERËSOHET
LART NGA BASHKËKOMBËSIT
TANË NË ZVICËR** F.15



Kërkohet që reforma zgjedhore të ndodhë sa më shpejt

Ish-anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Fadil Maloku dhe Blerim Burjani, kanë ftuar partitë politike që reforma zgjedhore të ndodhë sa më shpejt.



Maloku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se zonat zgjedhore duhet të maksimalizohen, kurse Burjani ka bërë me dije se duhet të ndodhë depolitizimi i institucionit i cili organizon zgjedhjet në Kosovë



**Rriten rastet
e falsifikimit
të parasë** F.9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT
**FERONIKELI DHE PRISHTINA
UA 'MBYLLIN' GOJËN
LOJTARËVE, LLAPI JO** F.20

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Mogherini vjen në Tiranë, takon Ramën dhe Bashën

TIRANË, 29 PRILL - Përfaqësuesja e Lartë e Komisionit Evropian, Federica Mogherini, do ta vizitojë Tiranën më datën 8-9 maj. Sipas burimeve, mësohet se zëvendës-presidentja e KE-së dhe komisionarja për Politikën e Jashtme do të marrë pjesë në aktivitetet në kuadër të Ditës së Evropës. Kjo vizitë do të shërbejë edhe si një tentativë e Mogherinit për t'i bindur palët për zgjidhjen e krizës politike

në vend, kjo pasi parashikohet që të zhvillojë takime me kryeministrin Edi Rama dhe me liderë të partive politike të opozitës.

Vizita e saj vjen disa javë përpara se Komisioni Evropian ta publikojë rekomandimin për hapjen ose jo të negociatave për Shqipërinë, më 29 maj dhe gati dy muaj para se të mbahen zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Edhe vitin e kaluar Mogherini

zhvilloi vizitë në Tiranë. Gjithashtu, mësohet se përfaqësuesja e lartë e KE-së, italianja Mogherini, është ftuar edhe nga presidenti Ilir Meta që të marrë pjesë samitin Brdo Brione, ku mblidhen të gjithë presidentët e Ballkanit për të diskutuar për projektet e përbashkëta dhe ndihma që duan nga BE-ja. Prania e saj në këtë samit konfirmohet nga burime zyrtare nga Presidenca.



Pragu zgjedhor hap debatin mbi formën e zgjedhjes së presidentit

Pasi që në raundin e parë për zgjedhjen e presidentit të Maqedonisë së Veriut dalja e votuesve ishte e ulët, kjo gjë ka hapur debatet se çfarë do të ndodhë nëse në raundin e dytë nuk arrihet pragu zgjedhor prej 40 përqindësh

SHKUP, 29 PRILL - Dalja e ulët e votuesve në raundin e parë për zgjedhjen e presidentit të Maqedonisë së Veriut ka hapur debatet se çfarë do të ndodhë nëse në raundin e dytë nuk arrihet pragu zgjedhor prej 40 përqindësh.

Në raundin e parë më 21 prill në votime dolën 41.79 për qind nga 1.8 milion qytetarë me të drejtë vote. Nga qeveria në disa raste nuk e kanë përfunduar mundësinë që në rast të dështimit, zgjidhjen ta kërkojnë në Kuvend, por pa përfunduar edhe mundësinë e heqjes së pragut zgjedhor. "Në rast të dështimit të zgjedhjes së presidentit në raundin e dytë, një nga opsionet është zgjedhja e kreut të shtetit në Kuvend. Por, si mundësi shihet edhe ajo që të mos ketë prag zgjedhor. Presidenti pra të zgjidhet nga qytetarët, por të mos ketë kufizime për dalje në votime. Në raundin e dytë president të zgjidhet ai kandidat që fiton më shumë vota, pavarësisht se sa

persona do të dalin në votime. Kjo do të pamundësojë bojkot apo forma të tjera për ta penguar zgjedhjen e të parit të shtetit", ka deklaruar ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska. Edhe kryeministri Zoran Zaev, njëherësh kryetar i LSDM-së, kishte deklaruar më parë se presidenti mund të zgjidhet nga Kuvendi në rast të dështimit në zgjedhjet e drejtpërdrejta. Por, që kjo të ndodhë duhet mbajtur raundi i dytë dhe, në rast të dështimit, atëherë partitë do të vendosin mbi formën e zgjedhjes së tij. Për zgjedhjen në Kuvend nevojiten ndryshime kushtetuese, pasi zgjidhja e tanishme nuk e parasheh një mundësi të tillë. Kushtetuta ndryshohet me dy të tretat e votave, që shumica parlamentare sërish do ta ketë të vështirë t'i sigurojë pa një mbështetje të gjerë.

Megjithatë, disa nga njohësit e çështjeve juridike thonë se zgjedhja e presidentit në Kuvend nuk është zgjidhja më e



mirë e mundshme, pasi kjo do ta zhveshë kreun e shtetit edhe më tej nga kompetencat, duke përqendruar pushtetin te qeveria që, sipas Naser Zyberit, ekspert juridik dhe ish-deputet, nuk është e mirë për demokracinë. "Në parim kjo nënkupton ngushtim të kapaciteteve të demokracisë në të cilën qytetarët me votën e tyre vendosin për përfaqësuesin më të lartë të shtetit. Pastaj zgjedhja e presidentit në Kuvend e sjell në shprehje mundësinë e pazareve politike mes liderëve të partive të përfaqësuar në Kuvend", thotë Zyberi, duke ngritur edhe çështjet etnike që, sipas tij, mund të çojnë në majorizimin

e bashkësive etnike nëse paraprakisht nuk sigurohen ndryshimet kushtetuese, që zgjedhja e tij të mos mund të bëhet pa votim të dyfishtë apo pa votat e shumicës së përfaqësuesve të etniteteve joshumicë. Zyberi thotë se zgjedhja e presidentit nga qytetarët do të ishte zgjidhja më e mirë dhe për ta motivuar daljen e tyre në votime, ai propozon zgjedhjen edhe të një nënpresidenti që në këtë rast do të ishte nga radhët e bashkësive etnike, apo shqiptar si komuniteti i dytë më i madh në vend. Kjo, sipas tij, do ta nxiste garën edhe mes shqiptarëve, ndërsa do t'i forconte edhe më shumë institucionet në vend, në kuptimin e ndarjes

së përgjegjësi dhe rritjes së transparencës. "Kjo do të ndikonte pozitivisht në dy drejtime, së pari që kandidatët për president detyrimisht do të kenë edhe kandidat për nënpresident nga radhët e shqiptarëve dhe, në këtë rast, Kushtetuta do t'i detyronte të jenë më të moderuar, më të përafërt me komunitetet e tjera. Po ashtu, kjo do t'i mobilizonte pjesëtarët e komuniteteve të tjera, në radhë të parë të atij shqiptar, që të jenë më aktivë sepse do ta nominonin kandidatin e tyre, me gjasë për t'u zgjedhur dhe jo si tani që paraprakisht dihet se kandidati shqiptar nuk kalon në raundin e dytë dhe me këtë ata nuk janë të interesuar për të marrë pjesë në votime", theksoi Naser Zyberi, njohës i çështjeve juridike.

Në rast të dështimit të zgjedhjeve, postin e presidentit të përkohshëm do të ushtronte kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, që do të ishte shqiptar i parë në postin më të lartë shtetëror në Maqedoninë e Veriut. Ai këtë post do ta ushtronte deri në gjetjen e mekanizmave për formën e zgjedhjes së presidentit të ri. (rfe)

Ja cilët janë kandidatët e konfirmuar të PS për kryebashkiakë

TIRANË, 29 PRILL - Partia Socialiste do ta publikojë së shpejti listën e plotë me 61 kandidatët për kryetarë bashkie, por kryeministri Edi Rama i ka konfirmuar shumë prej tyre që nga Kongresi i PS-së e deri te takimet e përjavshme nëpër rrethe.

Erion Veliaj, Sotiraq Filo në Korçë, Dritan Leli në Vlorë, Armando Subashi në Fier, Pjerin Ndreu në Lezhë dhe Majlinda Bufi në Roskovec janë

konfirmuar që në Kongresin e Partisë Socialiste. Më tej, Rama ka konfirmuar Safet Gjicin në Kukës, Fredi Kokoneshi në Divjakë, Arif Tafanin në Belsh, Tërmet Peçin në Tepelenë, Ndrec Dedajn në Mirditë, Kastriot Gurrën në Librazhd, Ervin Demon në Berat dhe Tonin Marinaj në Malësinë e Madhe. Dy prefektët e Shkodrës dhe Elbasanit, përkatësisht Gledian Llatja dhe Valdrin Pjetri, do të kandidojnë gjithashtu për

bashkitë. Gjithashtu, pritet që Rakip Suli t'lerë mandatin për të kandiduar në Kamëz, Ilir Xhangolli në Pogradec, Flamur Golemi në Gjirokastrë dhe Nuri Belba në Prenjas.

13 maji është afati i fundit i regjistrimit të kandidatëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe emrat e tyre pritet të zyrtarizohen në Asambleenë e Partisë Socialiste që do të zhvillohet javën e dytë të muajit maj.



Njohësit e proceseve zgjedhore ftojnë partitë për reformën zgjedhore

Kërkohet që reforma zgjedhore të ndodhë sa më shpejt

Ish-anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Fadil Maloku dhe Blerim Burjani, kanë ftuar partitë politike që reforma zgjedhore të ndodhë sa më shpejt. Maloku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se zonat zgjedhore duhet të maksimalizohen. Kurse Burjani ka bërë me dije se duhet të ndodhë depolitizimi i institucionit i cili organizon zgjedhjet në Kosovë

e UNMIK-ut) dosido u bë një 'këmishë' e ngushtë për të identifikuar, fuqizuar dhe faktorizuar subjekte meritokratike në skenën aktuale politike kosovare", ka thënë Maloku.

Ai ka treguar se çka duhet të përfshihet në reformën zgjedhore në mënyrë që të kemi një sistem me të drejtë zgjedhor. "Zonat zgjedhore duhet të maksimalizohen, sepse s'ka kurrfarë kuptimi që deputetët të mos kenë zonën e tyre zgjedhore, zonë kjo që dosido i 'disiplinon' dukshëm ata kur janë në pyetje llogaridhënia, përgjegjësia dhe transparenca në qëndrime publike. Po ashtu, reforma, në fakt, do të duhej ta përfshijë reduktimin e rolit të liderit (që aktualisht i ngjason një diktatori e autoriteti të padiskutueshëm që është në kundërshtim me demokratizimin e brendshëm), të cilit, në rastin tonë, i mundëson të jetë i përjetshëm, qe prapë është një

absurd i llojit të vet", ka thënë Maloku.

Edhe ish-anëtari tjetër i KQZ-së, Blerim Burjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se reforma zgjedhore duhet ta përfshijë edhe depolitizimin e këtij institucioni të pavarur. Sipas tij, formula aktuale e përfaqësimit të partive politike në KQZ nuk është adekuate. "Duhet patjetër të shkohet në depozitim të këtij organi. Edhe në të ardhmen ky institucion me formulën 2+2+2 që është bërë nga presidenti i vendit e ka bllokuar përfundimisht KQZ-në. Sepse edhe në të ardhmen çdo vendim që ka të bëjë me dy të tretat, KQZ-ja do të jetë organ i bllokuar", ka thënë Burjani.

Ai ka bërë me dije se KQZ-ja si institucion i cili organizon zgjedhjet në Kosovë duhet të jetë trup e pavarur dhe profesionale. "KQZ-ja si organ teknik-profesional nuk duhet të jetë e nxitur nga çështje politike, aq më pak

në situata të tilla kur është e rëndësishme për shtetin tonë dhe kur ka të bëjë me shprehjen e vullnetit të qytetarëve dhe implementimin e tij. Kësaj çështje nuk duhet t'i jepet konotacion politik, po teknik dhe profesional", ka thënë Burjani.

Ai ka kritikuar zvarritjen e fundit që ka ndodhur për certifikimin e katër kandidatëve të Listës Serbe, që pritet të garojnë për kryetarë të komunave veriore të Kosovës në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit. Sipas tij, në KQZ nuk duhet të bëhet politikë. "Po e përsëris edhe një herë, KQZ-ja nuk bën të manifestojë qëndrime politike, sepse ky është institucion teknik profesional. Aty ka vetëm kritere ligjore për certifikim. Mendoj se Vetëvendosja këso telashe do të bëjë edhe në të ardhmen, sa herë që nuk i konvenon certifikimi i rezultateve", është shprehur Burjani.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 PRILL - Njohësit e proceseve zgjedhore kanë ftuar subjektet politike që ta përshpejtojnë reformën zgjedhore të rekomanduar edhe nga institucionet ndërkombëtare. Ish-anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Fadil Maloku dhe Blerim Burjani, kanë përshëndetur iniciativën e partitëve politike parlamentare për nënshkrimin e një deklaratë të përbashkët, me anë të së cilës kanë shprehur gatishmërinë

dhe angazhimin e tyre për ta përmirësuar dhe forcuar procesin zgjedhor. Maloku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sistemi i tanishëm zgjedhor është bërë pengesë serioze për emancipimin tonë të mëtejshëm sociopolitik. "Natyrish se është pozitive kjo iniciativë edhe për faktin se sistemi i tanishëm zgjedhor po shihet dukshëm që është bërë pengesë serioze për emancipimin tonë të mëtejshëm sociopolitik. Them kështu edhe për shkakun se ky sistem (i trashëguar dhe i imponuar nga ish-administrata



Sot tërhiqet shorti për renditjen e kandidatëve në fletëvotimet për zgjedhjet në veri

PRISHTINË, 29 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se sot (e martë), në orën 11:00, do të tërhiqet shorti për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotimet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe

Zubin Potok. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, më 8 prill kashpallur datën e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovicë e

Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan do të mbahen më 19 maj. Katër kryetarët e këtyre komunave, më 27 nëntor të vitit 2018, kanë dhënë dorëheqje, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia.



Është mbajtur Samiti i Berlinit në të cilin kanë marrë pjesë liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor

Merkeli dhe Macroni konfirmojnë angazhimin për një zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë



Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emanuel Macron kanë shprehur përkushtimin e tyre për zgjidhjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këtë zotim ata e kanë dhënë të hënën në kuadër të Samitit të Berlinit, në të cilin kanë pritur në takim të përbashkët liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Merkeli me Macronin kanë bërë me dije se Gjermania dhe Franca do të angazhohen më shumë për stabilitetin dhe zhvillimin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, ata kanë thënë se zgjidhja e problemit në mes të Kosovës duhet të jetë në të mirë të gjithë rajonit. Sipas tyre, nuk mund të ketë marrëveshje, pasojat e së cilës mund t'i vuajnë vendet e tjera

mbrojtjes dhe drejtësisë. Pas takimeve të ndara me liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emanuel Macron kanë mbajtur konferencë të përbashkët për medie, në të cilën kanë shprehur përkushtimin e tyre për perspektivën evropiane të rajonit dhe për zgjidhjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kancelarja Merkel ka deklaruar se në takimin e Berlinit nuk do të sjellë ndonjë vendim, por do të diskutohet për gjetjen e një zgjidhje për Kosovën dhe Serbinë. Sipas saj, ideja e Gjermanisë dhe Francës është për t'i lehtësuar

gjërat e jo për t'i vështirësuar ato. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se zgjidhja duhet të jetë në të mirë të gjithë rajonit. Merkeli ka deklaruar se nuk mund të ketë marrëveshje pasojat e së cilës mund t'i vuajnë vendet e tjera. "Jemi të përkushtuar për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit, por kjo

EPOKA
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 PRILL - Nikoqirët e Samitit të Berlinit, kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emanuel

Macron, pasditen e së hënës kanë pritur në takim të përbashkët liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku është diskutuar për bashkëpunimin rajonal dhe perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Ata

kanë bërë me dije se Gjermania dhe Franca dëshirojnë ta forcojnë bashkëpunimin e tyre për stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet një agjende rajonale në sektorin e zhvillimit social, të sigurisë, të



Thaçi dhe Haradinaj takojnë ambasadorin amerikan në Gjermani, thonë se roli i ShBA-së është vendimtar për Kosovën

Presidenti Hashim Thaçi ka takuar ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell. Ai ka thënë se për Republikën e Kosovës është shumë i rëndësishëm koordinimi i ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas Thaçit, roli i ShBA-së ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë vendimtar për ne. "Për Republikën e Kosovës është shumë i rëndësishëm koordinimi i ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Para nisjes së Samitit të Berlinit, një takim

me rëndësi kishim edhe me ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell. Roli i ShBA-së ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë vendimtar për ne. Jemi të bekuar me mbështetjen e ShBA-së", ka thënë Thaçi. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj, në kuadër të vizitës zyrtare në Berlin, ka zhvilluar një takim me ambasadorin e ShBA-së në Gjermani, Richard Grenell, të cilit i ka shprehur përkushtimin e Kosovës për procesin e dialogut me

Serbinë, për konsolidimin e ekipit negociator të vendit dhe për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese, bazuar në ligjet dhe kushtetutën e vendit si dhe përkushtimin e Kosovës për tregti të lirë me Serbinë, si pjesë e një marrëveshje që rezultojnë me njohje reciproke. "Theksova se qeveria e vendit kundërshton fuqishëm idenë e këmbimit të territoreve, duke e cilësuar si opsion të rrezikshëm dhe që do ta destabilizonte jo vetëm vendin, por edhe rajonin", ka

deklaruar Haradinaj. Ambasadorit Grenell kryeministri i ka treguar edhe për progresin e arritur në vend në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit si dhe për përkushtimin e Kosovës për marrëdhënie të mira ndërfaqjësore gjithmonë në partneritet me aleatët tanë dhe me aspiratat tona për rrugën euroatlantike. "Roli i ShBA-së në proceset e mëtejme politike të vendit është i domosdoshëm", ka deklaruar Haradinaj.



s'ka të bëjë me zgjerimin. Gjermania dhe Franca duan të tregojnë se është në interes të përbashkët që ta shohin zhvillimin e Ballkanit. Në darkë do të diskutojmë se si mund ta gjejmë një zgjidhje për Kosovën dhe Serbinë. Ideja jonë është që të shohim se si të pajtohemi për t'i lehtësuar e jo vështirësuar gjërat. Zgjidhja duhet të jetë në të mirë të gjithë rajonit. Nuk mund të ketë marrëveshje pasojat e së cilës mund t'i vuajnë vendet e tjera. Ky është një format joformal që nuk e zëvendëson Procesin e Berlinit", ka deklaruar kancelarja Angela Merkel, duke përmendur zgjidhjen e konfliktit të Maqedonisë së Veriut si shembull pozitiv. Ajo përmendi çështjen e doganave të Kosovës ndaj Serbisë dhe Bosnjës si një zhvillim jo në drejtimin e duhur.

Kurse presidenti francez Emanuel Macron ka thënë se Franca do të angazhohet më shumë për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor si në vitet e '90. Ai ka thënë se agenda rajonale, pavarësisht nga ajo e zgjerimit, përbëhet nga katër sektorë: zhvillimi social, siguria, ku hyn lufta kundër trafikut ilegal të armëve, kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe emigracionit të parregullt; mbrojtja, ku hyn misioni evropian paqeruajtës në Bosnjë-Hercegovinë, si dhe sektori i drejtësisë dhe i forcimit të bashkëpunimit në luftën kundër kriminalitetit ekonomik.

Presidenti Macron ka thënë se është i bindur se stabiliteti realizohet me një agjendë rajonale. Në këtë kontekst, ai ka thënë se dëshirojnë që të vazhdojnë dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë por, sipas Macronit, nuk do të imponohet zgjidhje për Kosovën dhe Serbinë. "E kemi parë që ka mundësi të zgjidhjeve siç është rasti i Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut. Kjo ndodh kur njerëzit janë të guximshëm. Çështja kryesore e diskutimit do të jenë Kosova dhe Serbia. Duam që ta vazhdojnë dialogun. Nuk duam të imponojmë zgjidhje për Kosovën dhe Serbinë. Shpresojmë që të mos ketë emocione në rrugën përpara dhe vështirësi të reja. Ku ka tensione, duam t'i adresojmë", është shprehur presidenti Emmanuel Macron. Merkel dhe Macron kanë theksuar se Samiti i Berlinit nuk e zëvendëson as 'Procesin e Berlinit' e as negociatat e zgjerimit të BE-së.

Thaçi: Pajtimi mund të ndodhë kur Serbia dhe Bosnja e njohin pavarësinë e Kosovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur një fjalim në hapje të Samitit të Berlinit, ku ka thënë se pajtimi do të jetë i pamundur për aq kohë sa Serbia dhe Bosnja nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Ai ka thënë se këto vendime të guximshme nga shtetet e rajonit nuk do të ndodhin për aq kohë sa nuk ka vendime të guximshme nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare. Sipas Thaçit, Gjermania dhe Franca kanë mundësi ta marrin leadershipin për këto vendime të guximshme. "Në hapjen e

Samitit të Berlinit fola për bashkëpunimin rajonal dhe pajtimin. Situata dhe relacionet janë në nivel të ulët, prandaj në rrethana të tilla shumë iniciativa të mira nga Procesi i Berlinit kanë mbetur pa u realizuar. Kjo situatë e keqe nuk mund të tejkalohet vetëm me deklarata dhe premtime abstrakte. Duhet vendime të guximshme nga shtetet e rajonit, të cilat nuk do të ndodhin për aq kohë sa nuk ka vendime të guximshme dhe strategjike nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare. Edhe pajtimi do të jetë i

pamundur për aq kohë sa Serbia dhe Bosnja e Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Gjermania dhe Franca kanë mundësi ta marrin leadershipin për këto vendime të guximshme. Por, një prej vendimeve të para që Bashkimi Evropian do të duhej ta merrte është liberalizimi i vizave për qytetarët tanë. Kosova padrejtësisht ka mbetur vendi më i izoluar në Evropë. Qytetarët e Kosovës janë populli më proevropian në rajon dhe është shumë e padrejtë të vazhdojnë

Thaçi takon Mogherinin: Kosova është e gatshme ta rifillojë dialogun në Bruksel

Para mbajtjes së Samitit të Berlinit, presidenti Hashim Thaçi, i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministri i parë, Behgjet Pacolli, ka takuar përfaqësuesen e lartë të BE-së për Politikë të Jashtme, Federica Mogherini. Ai ka bërë me dije se Kosova është e gatshme ta rifillojë dialogun në Bruksel. "Për ne, fqinjët tanë dhe vetë Bashkimin Evropian, një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është jetike që të ecim të gjithë përpara së bashku. Pas arritjes së marrëveshjes ndërmjet Maqedonisë Veriore dhe Greqisë, kjo marrëveshje do t'i sillte edhe më shumë paqe dhe stabilitet rajonit dhe Evropës. E kemi përkrahjen e Bashkimit Evropian, ShBA-së dhe tërë botës për ta arritur një marrëveshje paqësore, përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse me Serbinë. Ne jemi të gatshëm ta rifillojmë dialogun në Bruksel", ka thënë presidenti Thaçi.

të diskriminohen", ka deklaruar Thaçi.

Në këtë samit krah Thaçit dhe Haradinajt ishte edhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Kërkohet nga bashkatdhetarët forcimi i marrëdhënieve bilaterale me Gjermaninë

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë takuar të hënën bashkatdhetarët në Ambasadën e Kosovës në Berlin, ku kanë kërkuar forcimin e marrëdhënieve bilaterale në mes të dy vendeve. Me këtë rast Thaçi ka vlerësuar kontributin e diasporës për lirinë, pavarësinë dhe shtetndërtimin e Kosovës. "Diaspora jonë në Gjermani tash e katër dekada pareshur i ka mbështetur të gjitha proceset në Kosovë: lirinë, pavarësinë, shtetndërtimin. Për këtë të fundit, së bashku mund të bëjmë edhe më shumë. Në Gjermani kemi shumë biznesmenë të suksesshëm, të cilët me investime në Kosovë e kanë ndihmuar edhe zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë. Jam shumë krenar me rrëfimet e sukseseve të tyre në Gjermani", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Edhe kryeministri Haradinaj ka vlerësuar angazhimin dhe rolin



e madh që diaspora në Gjermani ka luajtur nëpër të gjitha proceset në të cilat ka kaluar vendi. Ai ka theksuar se Gjermania ka ofruar trajtim dhe mikpritje për njerëzit tanë në kohët më të vështira sociale, ekonomike dhe të sigurisë. "Ju falënderoj juve dhe shtetin gjerman që po vazhdoni të mbani qëndrim konsistent, që të mos dëmtohet integriteti territorial dhe shtetësia e Kosovës. Vizita zyrtare në Berlin dhe ky takim është rast i

mirë ta forcojmë lidhjen tonë bilaterale që e kemi Kosovë - Gjermani. Sfida dhe vështirësi kemi mjaft, por Kosova do të ecë përpara dhe besoj se edhe nga ky takim i sotëm do të dalim edhe më të konsoliduar si Kosovë në planin rajonal dhe global", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se diaspora ndër vite ka qenë shtyllë e konsolidimit të shtetësisë së Kosovës, përkrahje e rezervë e ekonomisë si dhe model i suksesit.

E kundërta e luftës nuk është paqja, por arti

Drama "Refuge", e cila të shtunën u dha premierë para publikut të teatrit "Baruch Performing Arts Center" në Nju Jork, tematikisht paraqet humanizmin dhe sakrificën e shqiptarëve gjatë LDB-së në ndihmë një familje hebreje, e mbështetur në kodin etik dhe jetësor të besës, ndërsa artistikisht ndërthurjen e mrekullueshme të tipareve qenësore të teatrit modern: lojës dhe tekstit. E luajtur para një publiku si ai i Nju Jorkut ajo, në aspektin e marrëdhënies politikë-kulturë, i bën thirrje ndërgjegjes së pushtetarëve kosovarë për nxitje dhe përkrahje të projekteve kulturore, sidomos të atyre që prezantojnë vlerat tona në botë

Pal NDRECAJ, Nju Jork

Tre aktorë kosovarë dhe tre aktorë amerikanë kanë sjellë para publikut njujorkas të teatrit "Baroch Performing Arts Center" dramën jetësore të një familje hebreje të mesit të shekullit XX dhe të një familje shqiptare në fund të atij shekulli, të inskenuar në bazë të tekstit të Mat Opatny. Për publikun e këtij teatri këto i ka "zbërthyer" në mënyrë të shkëlqyeshme e të plotë, deri në shkallë përjetimi, regjia e mrekullueshme e Florent Mehmetit dhe Jessica Burrit, teksti i shkurtër, i qartë, i plotë e konciz i Mat Opatny, loja e përkushtuar e aktorëve Ilire Vinca, Eshref Durmeshi, Daniela Markaj nga teatri "Oda" dhe Nancy McArthur, Becca Schneider dhe Perry Yaniv, aktorë amerikanë. Natyrisht këtë sukses e ka mundësuar edhe teksti në dy gjuhë.

Drama është e bazuar mbi një ngjarje të vërtetë. Një familje hebreje, burrë, grua dhe vajzë, që ndiqet nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, merret në mbrojtje nga një familje shqiptare që ka po aq anëtarë: burrë, grua dhe vajzë. Familja mikpritëse i mbron nga nazistët, duke u dhënë identitet të rremë shqiptar. Kontakti ndërmjet dy familjeve me kultura të ndryshme vë në pah para shikuesit vlerat e familjes mikpritëse, sakrificën e saj për mysafirët, befasinë që krijon e gjithë kjo te familja hebreje, duke e ngritur dramacitetin e lojës dhe përjetimin emocional në shkallën më të lartë. Në kushte të vështira politike, sociale e ekonomike, njerëz që mezi ushqejnë veten marrin përsipër barrën e rëndë të mbajtjes edhe të një familje

tjetër, sepse ashtu e kërkon nevoja e familjes hebreje dhe ashtu e do kodi jetësor i familjes shqiptare. "Moskuptimet" mes dy familjeve shkaktohen për çfarëdo, duke prekur çështje që kanë të bëjnë me kulturat e tyre, me doket zakonore, stilin e jetës e norma të tjera socio-kulturore. Në dramë, disa herë, ndodhin momente të fuqishme komike, të cilat në njërin anë freskojnë atmosferën në sallë e në anën tjetër ndërtojnë aspektin kontrastik të tipareve socio-kulturore të mënyrave të jetesës te popuj të ndryshëm: familja hebreje, së cilës familja shqiptare ia lëshon të vetmen dhomë gjumi që kishte, kundërshton këtë, pos të tjerash, edhe me argumentin se nuk kanë para për të paguar. Mirëpo, çmimi është i paguar dhe faturën e kësaj e ka marrë përsipër vullnetarisht një kod i fuqishëm jetësor, vështirë i kuptueshëm për ta, kodi i mikpritjes dhe i besës: "Në rend të parë shtëpia e shqiptarit është e Zotit, në rend të dytë e mikut dhe në rend të tretë e jona", ua shpallin mikpritësit. Mirëpo, kjo nuk mjafton për t'i sqaruar hebrenjtë sepse, diku në mes të kuptimit të drejtë të vlerave të këtij kodi, kishin hyrë paragjykimet e ndryshme që shpërfaqen në formën e frikës e mosbesimit:

"Po ju a jeni myslimanë?" pyet familja hebreje, duke shpënë ngjarjen në kulminacionin e saj. Dhe është përgjigja e gruas shqiptare, Zojës, rolin e së cilës e luan Ilire Vinca, në të cilën përgjigje, në mënyrën më të mrekullueshme teksti, mimika, intonacioni i zërit etj. bashkëveprojnë harmonishëm në radhitjen e prioriteteve vlerore të shqiptarëve: "Kanë ardhë këtu



romakët, na jemi ba katolikë, kanë ardhë otomanët, na jemi ba muslimanë... katolikë... muslimanë... ortodoksë... iiiihaaaaa", por besa ka mbetë e pandryshueshme".

Fate popujsh në kohë të ndryshme

Kohët nuk takohen, nuk puçen. Koha lëviz në një vijë drejtvizore dhe ka vetëm një kahje. Takohen e puçen fatet e njerëzve, në pikën më tragjike të tyre. Kështu, familja shqiptare, 50 vjet pasi kishte mbrojtur familjen hebreje, përjeton vetë fatin e saj. Tash janë shqiptarët ata që përjetojnë tmerrin e dhunës çnjerëzore, që rrjedh kanaleve të njëjtë të urrejtjes patologjike ndërmjet kombeve. Familja kosovare provon gjithë fatin e keq të luftës, dhunën e shfrenuar serbe me intencën e shfarosjes etnike, sikurse 50 vjet më parë familja hebreje. Kohët që nuk takohen në jetë, takohen aq bindshëm në skenën e një teatri që di të luajë me to, që di t'i afrojë në funksion të temës, të ideve e të mesazheve që do të transmetojë. Në pak minuta takohen dy periudha kohore, dy histori dhe dy figura që i përfaqësojnë ato, natyrisht, përmes pasojave që kanë shkaktuar dhe gjurmëve që kanë lënë në kujtesën e njerëzimit - figura e Hitlerit gjerman dhe e Millosheviqit serb. Historia ia ka dhuruar njeriut vuajt-

jen, por edhe mundësinë për ta mposhtur atë, për ta ndërtuar shpresën e optimizmin dhe për ta ngritur godinën e lumturisë. Anëtarë të të dy familjeve, pas 6 dekadash takohen në Nju Jork. Mirëpo, tash, në brezat e tjerë të saj. Takimi është i mbështjell me vel mitik që, po ashtu, lidhet me kode shqiptare të jetës, amanetin: familja shqiptare ruan një gjësend të familjes hebreje me vlerë kujtimore, të cilin send nuk e kishte tjetërsuar koha dhe nuk e kishte mbështjellë harresa, për t'ua dorëzuar një ditë trashëgimtarëve të saj.

Si puçen dhe si ndahen mitikja me realen

Përderisa kodi i besës shqiptare, në shumë trajtime mbithekson karakterin mitik të saj, në dramën "Refuge" ajo shihet si një vlerë praktike, e lindur dhe e jetuar në kushtet historike reale si një nevojë e njeriut për ta manifestuar veten në përmasa humane, në kushtet e krizave dhe zvetënimit moral. Bashkëpunimi i teatrit "Oda" me atë "Blessed unrest", i cili tashmë ka historikun e vet që nis që nga viti 2005, ka paraqitur edhe një rast të bukur për afirmimin e vlerave humane e të sakrificës që populli ynë në saje të atij kodi i ka jetuar me fanatizëm. Rëndësia e afirmimit të këtyre vlerave në shkallë botërore

dhe në një skenë të madhe si ajo e Nju Jorkut, nënkupton edhe afirmimin e një vlere tjetër, vlerën e prosperimit të kauzës sonë, e cila si angazhim politik me kosto të lartë mund të ndihmohet mirë nga angazhime kulturore, që kanë kosto më të vogël, siç është një trupë pasionante e një teatri ambicioz. Këtë e ndiejnë dhe e kuptojnë të gjithë, por më së miri e ndien nëse të jepet rasti të jesh në atë shfaqje, të ndërrosh pas saj dy fjalë me ardashësit e pasionuar amerikanë në hollin e teatrit, të vazhdosh në bisedë shoqërore kureshtjen e tyre për tematikën e dramës, për historinë e popullit e të kulturës, t'i dëgjosh opinionet e tyre rreth vlerave njerëzore e artistike e t'i përjetosh emocionet e takimeve me aktorët.

Kjo, ashtu sikurse e gjeti përmbushjen e saj tek shqiptarët e Nju Jorkut, që përmbanin afërsisht një të tretën e shikuesve, duhet ta gjejë edhe te strukturat kulturore të shtetit të Kosovës, për ta gëzuar përkrahjen e duhur. "E kundërta e luftës nuk është paqja, por arti, e tha në takimin me publikun autori i tekstit". E zëri ynë ka shumë nevojë të jehojë përmes formave të shprehjes artistike; kemi nevojë të komunikojmë me botën dhe me Amerikën përmes teatrove. Por, para së gjithash, teatrot duhen përkrahur.

Ismaili: Zgjedhjet dikur do të vijnë

PRISHTINË, 29 PRILL - Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Uran Ismaili, i cili njëherësh është edhe ministër i Shëndetësisë, e sheh të pashmangshme mbajtjen e zgjedhjeve, por thotë se nuk e di kur do të mbahen ato. Ai në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se partitë politike duhet të jenë të gatshme për zgjedhje kurdo që mbahen ato. "Zgjedhjet dikur do të vijnë, se për çfarë do të vijnë dhe kur, nuk mund të komentoj sepse nuk kam përgjigje, mirëpo kurdo që të jenë, partitë politike i kanë



planet e tyre dhe duhet të jenë të gatshme që të realizojnë dhe të hyjnë në zgjedhje. Kjo është një

çështje që e parasheh edhe ligji i Kosovës, që ka afate dhe pas tyre gjitha partitë politike që duan të

hyjnë në zgjedhje i paraqesin oferta e tyre, prandaj për aq kohë sa të gjithë janë në pozicione të tyre, brenga kryesore duhet të jetë jeta e qytetarit", ka thënë Ismaili.

Sipas tij, PDK-ja është partia kryesore në vend me trupë elektorale më të gatshme për të marrë përgjegjësi. "Ajo që është me rëndësi është se për aq kohë sa jemi të gjithë në pozicionet tona institucionale të arrijmë që të bëjmë më të mirën për qytetarin, pra ka një pritje të madhe të qytetarëve për realizimin e projekteve të shumta jo vetëm në

shëndetësi, por në arsim, rini dhe në shumë fusha të tjera. Ne duhet të krijojmë këtë energji e cila mbërrin për t'i përfunduar projektet në mënyrë që ato të jenë reale dhe të prekshme për qytetarët, të mos jenë projekte që mbesin në letër, por që realizohen. Pra, mendoj se kjo është me rëndësi", ka thënë ai. Ai ka pohuar se pjesëmarrja prej 41 mijë vetash në procesin zgjedhor në PDK tregon se qytetarët PDK-në e shohin si shpresë dhe realizim të transformimeve që mund të ndodhin dhe priten të ndodhin në Kosovë.

Mbi 245 mijë lëndë presin zgjidhje në gjykata

Në gjykatat e Kosovës vazhdon të ketë numër të madh të lëndëve të pazgjidhura. Aktualisht janë mbi 245 mijë lëndë të vjetra apo të reja që presin zgjidhjen nga gjykatat në mbarë Kosovën. Por, sipas drejtuesve të sistemit të drejtësisë, ky numër do të bjerë, pasi në gjykatat e Kosovës ka një angazhim të shtuar të zyrtarëve përgjegjës lidhur me këtë çështje



PRISHTINË, 29 PRILL - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skënder Çoçaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se janë dy gjykatat, ajo e Themelore dhe e Apelit, të cilat janë më të ngarkuar me punë por, sipas tij, me angazhimin e rreth 60 gjyqtarëve të rinj, numri i lëndëve do të zbresë. "Në aspektin e përgjithshëm të ngarkesave të lëndëve mund t'ju them se, përveç Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku kemi problem pak, edhe Gjykatës së Apelit në divizionin civil, në gjykatat e tjera, në të gjitha gjykatat e Kosovës, numri i lëndëve nuk është i madh. Do të thotë, një numër i lëndëve të vjetra janë kryer", ka thënë Çoçaj.

Kryesuesi Çoçaj ka theksuar se, përveç në Gjykatë Themelore në Prishtinë, në gjykatat e tjera shqyrtimi i lëndëve përfundon në një afat të shpejtë. "Nëse e krahasojmë [numrin e lëndëve] me fillimin e vitit 2018 dhe përfundimin e vitit 2018, numri i lëndëve ka zbritur dukshëm, mirëpo lëndët kryhen dhe vijnë vazhdimisht çdo ditë. Pra, numri nuk mund të vijë në zero

për shkak se lëndët vazhdimisht vijnë në gjykata", ka deklaruar Çoçaj.

Në Institutin e Kosovës për Drejtësi, institut ky që bën monitorimin e punës së sistemit të drejtësisë, thonë se ka rënie të numrit të lëndëve të cilat janë zgjidhur. Megjithatë, sipas tyre, në gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës ende ka nevojë për ndryshme dhe përmirësime.

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Ehat Miftaraj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se për zvogëlimin e lëndëve në gjykatë nuk ka një menaxhim të duhur. "Qytetarët e Kosovës ende ballafaqohen me vonesa të shumta për trajtimin e lëndëve të tyre dhe kjo më së shumti vërehet te çështjet civile dhe administrative. Edhe pse në kohët e fundit ka pasur rritje të numrit të gjyqtarëve si rezultat i mosmenaxhimit dhe administrimit të përshtatshëm të gjykatave, qytetarëve iu duhet me vite të presin për t'i zgjidhur çështjet e tyre në gjykata", ka thënë Miftaraj.

Ndryshe korrupsioni në

gjyqësi, mosefikasiteti, grumbullimi i lëndëve, ngadalësimi në reforma janë vetëm disa prej kritikave më të shpeshta që i janë bërë sistemit të drejtësisë për vite me radhë nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Miftaraj ka thënë se në sistemin e drejtësisë ende nuk punohet drejt dhe pa anime. "Në raste të caktuar, kur flasim për njerëzit e privilegjuar, e njëjta nuk vlen edhe për ta. Përderisa për qytetarët e thjesht duhet vite për ta trajtuar e zgjidhur një rast, për qytetarët e privilegjuar që kanë pozita, lëndët e tilla kryhen për tre muaj nga ana e gjykatave, që ngre shqetësimin e qytetarëve, që drejtësia në Kosovë nuk zbatohet në mënyrë të drejtë për të

gjithë, por në bazë të funksioneve që personat e caktuar kanë në shoqëri", ka thënë Miftaraj. Në Institutin e Kosovës për Drejtësi thonë se politika dhe grupet e interesit kanë prodhuar një sistem të drejtësisë, i cili, në vend se të prodhojë drejtësi dhe siguri juridike, është shndërruar në mekanizëm persekutimi për individë të caktuar në emër të luftës kundër korrupsionit, si dhe mjet efikas për të ofruar pandëshkueshmëri dhe amnisti për zyrtarë të caktuar brenda sistemit të drejtësisë, politikës dhe grupeve të interesit. Autoritetet në Kosovë nuk mendojnë se sistemi i drejtësisë në vend është pre e ndikimeve politike, ashtu siç është thënë

në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) mbi të Drejtat e Njeriut.

Ministri i Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se në vazhdimësi ka kërkuar nga prokurorët dhe gjyqtarët që të punojnë në mënyrë të pavarur dhe të mos u nënshtrohen ndikimeve nga jashtë. Drejtuesit e mekanizmave të drejtësisë në Kosovë pohojnë se sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të përballet me probleme dhe sfida. Sipas tyre, pavarësisht prej punës së bërë, nuk do të thotë se është bërë sa duhet për ta kthyer besimin e duhur të qytetarëve në gjykata dhe prokurori.

Pas iniciativës së Veselit, ShBA-ja reagon e para për krimet e Serbisë në Kosovë



PRISHTINË, 29 PRILL - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë sërish të parat që kanë nisur të reagojnë në mbrojtje të Kosovës për t'i dënuar krimet serbe 20 vjet pas luftës. Pas letrës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili ua ka dërguar të gjitha shteteve mike, duke u kërkuar të nxjerrin rezoluta që i dënojnë krimet serbe në Kosovë, Kongresi Amerikan tashmë ka reaguar i pari. Sot (e martë) Kongresi Amerikan do ta mbajë një seancë dëgjimore lidhur me 20-vjetorin e përfundimit të luftës, në të cilën do të dëshmojnë për krimet serbe në Kosovë: Ilir Bytyçi, Atifete Jahjaga dhe Vasfije Krasniqi-Goodman.

"Klan Kosova" e ka siguruar agjendën e seancës dëgjimore që do të mbahet nesër në Kongresin Amerikan për krimet e kryera nga serbët në Kosovë.

Edhe ambasadorët e ShBA-së në Kosovë dhe Serbi kanë reaguar pas letrës së nisur nga kryeparla-

mentari Veseli. Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ditë më parë u pa përkrah Veselit në Mejë të Gjakovës në 20-vjetorin e masakrës që kryen serbët, ku kërkoi ndëshkimin e kriminelëve. Edhe ambasadori amerikan në Serbi, Kyle Scott, ditë më parë ka thënë se askush nuk mund t'i mohojë krimet që Serbia kreu në Kosovë gjatë luftës.

Iniciativa e kryeparlamentarit Kadri Veseli, për t'u dërguar letër me argumente për krimet serbe, ka ardhur në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe pas përpjekjes së vazhdueshme nga krerët e shtetit serb për t'i mohuar masakrat dhe krimet që ka kryer Serbia gjatë luftës në Kosovë.

Letra e kryeparlamentarit Veseli synon që nëpërmjet rezolutave, parlamentet e vendeve mike të Kosovës ta institucionalizojnë kujtimin dhe të vërtetën e krimeve që ka bërë Serbia në Kosovë.

Gjuha e komunikimit e shqiptarëve të partizuar



Nga: Jakup KRASNIQI

Ka kohë që përiqem ta vështroj gjuhën e komunikimit, në mënyrë të veçantë, gjuhën parlamentare të të zgjedhurve të popullit, të atyre që e përfaqësojnë pozitën si dhe të atyre që përfaqësojnë opozitën. Në shikim të parë, kur njeriu dëgjon debatet në mes të pozitës dhe të opozitës shqiptare, e krijojnë përshtypjen se është duke dëgjuar përfaqësues të dy kombeve, të armiqësuar ndër dekada dhe që nuk synojnë ta gjejnë as edhe një fije interesi që i bashkon! Vërtet një armiqësim i tillë jo vetëm që nuk i duhet kombit brenda tij, një kombi që synon progresin, zhvillimin, mirëqenien kombëtare e shtetndërtimin për sigurinë kombëtare, por kjo gjuhë është shumë e dëmshme edhe po qe se përdoret edhe në mes të kombeve fqinje, që edhe mund të kenë pasur mes tyre shekuj armiqësie. Gjuha në rend të parë është mjet komunikimi e mirëkuptimi në mes të njerëzve që flasin të njëjtën gjuhë, por që

gjithherë, në të gjitha kohët historike ka qenë nevoja, që nga krijimi i gjuhëve që njerëzit (përfaqësuesit e popujve të ndryshëm), ta gjejnë gjuhën e përbashkët të komunikimit, të marrëveshjeve e të mirëbesimit. Deri sot, cilitdo popull a komb që i është dashur progresi shoqëror e ekonomik, asnjëherë nuk iu ka mjaftuar vetvetja e më se paku në kohën e globalizmit.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është që të merrem me historinë e komunikimit në mes kombeve të ndryshme të botës, por të shkruaj për kulturën e komunikimit të folësve të gjuhës shqipe në institucionet e shteteve shqiptare, përfshirë dhe institucionin më të lartë përfaqësues, siç janë Kuvendi i Shqipërisë dhe ai i Kosovës, si dhe komunikimi jashtë parlamenteve tona, në mes të përfaqësuesve të pozitës e të opozitës, kudo ku ajo shfaqet. Kjo formë e komunikimit që e dëgjojmë dhe e shohim përditë në medie të ndryshme të shkruara (shtypura) e elektronike, ekrane televizive, etj. nuk prodhon as kulturë e as progres, prodhon armiqësi e shkatërrim, prapambetje e mjerim!

Si shkas për t'u marrë me këtë çështje, është deklarata e një përfaqësueseje të pozitës për një parti opozitare. Deputetja i thoshte një partie opozitare se ishin "fundërrina"! Term tepër i përgjithësuar! Nëse një parti

opozitare mund të cilësohej si "fundërrinë", cili ishte dallimi i partisë së saj nga "fundërrinat" e një gjuhe e të një gjaku, të një kulture e të një vendi? Shikuar realisht, kjo nuk është ndonjë risi në komunikimin tonë të përditshëm, madje jo vetëm në mes pozitës e opozitës! Pa asnjë dyshim, kjo nuk është as gjuha më e ashpër që kemi dëgjuar e dëgjojmë, por është e ashpër në kontekstin që është thënë. Kjo gjuhë komunikimi, që dëgjohet shpesh në kuvendet shqiptare, behet e papranueshme dhe e padurueshme për faktin se nuk i ndihmon daljes së duhur nga gjendja që po rrezikojmë të futemi. Populli e ka një urti, e cila thotë: "Sipas vendit kuvendi". Tek ne, jo vetëm tani, por sidomos tani, nuk është as koha, as vendi e as kuvendi, për komunikime që nuk i ndihmojnë zgjidhjes që e kërkon interesi i kombit dhe i vendeve tona, vende që kanë shumë probleme serioze me ligjin, progresin e zhvillimin.

Me këtë që thashë, nuk kam ndërmend që t'i mbys idetë e kundërta e as dialektikën e të kundërtave, se pa ide të kundërta e kundërshtit, bota nuk do të ishte zhvilluar në këtë nivel, por edhe idetë e kundërta me kundërshtitë e tjera dialektike, mund të thuhet dhe duhet të thuhet me kulturë, edukatë e fjalë të zgjedhura, që thonë shumë e nuk shkaktojnë

lëndime tek ata që u adresohen e as tek ata që i dëgjojnë. Secila gjuhë në fjalorin e saj ka fjalët e ashpra, por i ka edhe fjalët që e zëvendësojnë edhe ashpërsinë dhe e intelektualizojnë gjuhën e përdoruesit. Gjuha e ashpër, që thuhet në rrugë në gjendje afekti, prodhon grushte e ne përditë po dëgjojmë se po shkrepën dhe plumba, po humbasin jetë të shtrenjta të të rinjve tanë. Secili nga ne, që i dëgjon lajmet e përditshme, dëgjon jo pak lajme nga kronikat e zeza dhe ato kronika e kanë një bazë, gjuhën jonormale të komunikimit ose shprehjet e pakontrolluara të thëna në afekt. Prandaj, është më se e domosdoshme që politika e jonë të ndahet njëherë e mirë nga gjuha e rrugës. Zakonisht gjuha e rrugës hynë në institucione kur njerëzit humbasin arsyen, apo iu mungojnë argumentet. Forca kurrë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë argument. Në politikë, aty ku do të ishin të urtit e popullit, argumenti është forcë! Duke përfunduar, dua të them se gjuha e "të urtëve" të kombit, e përdorur në Tempujt e Demokracisë që 25 vjet në Shqipëri e Maqedoni dhe 15 vjet në Kosovë, nuk arritën t'i konsolidojnë shtetet, sistemet e drejtësisë e të sigurisë, zhvillimin ekonomik e perspektivën për punë e jetë të dinjitetshme, arsimin në përgjithësi dhe

arsimin e lartë në veçanti si dhe shëndetësinë publike, ambientin dhe planifikimin hapësinor, mediet profesionale dhe komunikimin publik. Përkundrazi, degjeneruan gjithçka: gjuhën shqipe e komunikimin masiv, kulturën e traditat e bukura kombëtare, mirësjelljen e mirëkuptimin ndërnjerëzor. Mikpritjen dhe besën shqiptare i kthyen në armiqësi e pabesi, çdo interes kombëtar e kthyen në babëzi personale! Përderisa kombit shqiptar perspektivë të vetme ia lanë ikjen nga Atdheu! E çka t'u themi të gjitha këtyre gjërave të bëra kaq mbrapsht? Kjo gjeneratë politikanësh që kombin e solli në këtë gjendje të pa perspektivë e me shpresa të thyera, nuk mundet dot ta kalojë vetveten! Duhet një gjeneratë e re politikanësh, që idealet e përmbytura të kombit t'i kthejë për së mbari! Ky ndryshim mund të bëhet vetëm përmes një mobilizimi të jashtëzakonshëm të potencialit të madh intelektual dhe profesional që ka Kosova e që fatkeqësisht kanë mbetur të marginalizuar nga bartësit mediokër të institucioneve shtetërore dhe partiake. Kam shpresa të mëdha se demokracia do të ngadhënjej mbi të gjitha format e diktatit dhe nënshtrimit. Rruga e lirisë së plotë nuk ndalet!

(Shkruar në shtator të vitit 2016)

Policia konfiskon mbi 11 kilogramë substancë narkotike në Merdare

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, kanë konfiskuar mbi 11 kilogramë substancë të dyshuar narkotike në Merdare. Substancat narkotike janë gjetur në një autobus të një kompanie turistike me targa (KS) në bagazhin e të cilit kanë qenë tri çanta, ku në to kishte dy zmadhues zëri dhe një klimë për ftohje, ndërkaq në brendësi të tyre janë gjetur njëmbëdhjetë paketime me bari ngjyrë të gjelbër, e dyshuar si substancë narkotike e llojit marijuanë, me peshë 11 kilogramë e 65 gramë. "Policia e Kosovës respektivisht Drejtoria e Antidrogës, ka pranuar një informatë nga njësia mobile e Doganës së Kosovës, e cila në pikëkalimin kufitar në Merdare kishte ndaluar një autobus të një kompanie turistike me targa (KS), e cila mban linjën e rregullt nga Prishtina me një shtet tjetër evropian. Gjate kontrollimit të autobusit, udhëtarëve si dhe valixheve të tyre, në bagazhin e autobusit kanë qenë tri çanta, e në to kishte dy zmad-



hues zëri dhe një klimë për ftohje, kurse në brendësi të tyre janë gjetur njëmbëdhjetë paketime me bari ngjyrë të gjelbër, e dyshuar si substancë narkotike e llojit marijuanë, me peshë 11

kilogramë e 65 gramë", është thënë në komunikatën e policisë.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë Njësia e Antidrogës në Prishtinë, njësia K9 si dhe forenzika

rajonale e Prishtinës e cila ka bërë fotografimin, matjen dhe tërheqjen e dëshmive. Në lidhje me rastin është kontaktuar prokurori kujdestar dhe me urdhër të tij autobusi ndalohe për

një kontroll të detajuar, përderisa janë intervistuar edhe dëshmitarë të rastit. Policia me njësitet kompetente është në proces të hetimit të rastit dhe identifikimit të të dyshuarit të përfshirë.

Tregtia prin për numrin e ndërmarrjeve të regjistruara

Numri më i madh i ndërmarrjeve vazhdon të jetë në sektorin e tregtisë me 2 525 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimit me 1 109 ndërmarrje. "Në sektorin e hotelerisë janë regjistruar 988 ndërmarrje të reja dhe në sektorin e ndërtimit me 959 ndërmarrje", është thënë në raportin e BQK-së për vlerësimin e TM4 2018



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 PRILL - Sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), tregues i rëndësishëm i zhvillimeve në sektorin real është edhe numri i bizneseve të reja të regjistruar, ku gjithsej janë 9 850 ndërmarrje të reja, sipas raportit të BQK-së për vlerësimin e katërmujorit të fundit (TM4) të vitit 2018.

Edhe numri i ndërmarrjeve të mbyllura ishte më i vogël, 1 426 sosh apo 12.1 për qind më pak krahasuar me vitin 2017. "Për

dallim nga viti 2017 që ishte karakterizuar me numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara, në vitin 2018 janë regjistruar 9 805 ndërmarrje të reja apo 6.3 për qind më shumë krahasuar me vitin 2017", thuhet në raportin e BQK-së. Sipas BQK-së, vetëm në TM4 2018 janë regjistruar 2 401 ndërmarrje të reja apo 25.0 për qind më shumë krahasuar me TM4 2017, kurse janë mbyllur 444 ndërmarrje apo 2.8 për qind më shumë krahasuar me TM4 2017. "Numri më i madh i ndërmarrjeve vazhdon të jetë në sektorin e tregtisë me 2 525 ndër-

marrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimit me 1 109 ndërmarrje. Në sektorin e hotelerisë janë regjistruar 988 ndërmarrje të reja dhe në sektorin e ndërtimit 959 ndërmarrje", është thënë në raport, duke u shtuar se, krahasuar me vitin 2017, në shumicën

e sektorëve është shënuar numër më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara. "Në sektorin e prodhimit janë regjistruar 219 ndërmarrje më shumë, në sektorin e ndërtimit 120 ndërmarrje më shumë, në sektorin e tregtisë 63 ndërmarrje më shumë etj.

Ndërsa sektorët që shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i bujqësisë (196 ndërmarrje më pak), transportit (38 ndërmarrje më pak), aktivitetëve financiarë (26 ndërmarrje më pak) etj", thuhet në raportin e BQK-së.

Banka Botërore: Çmimet e naftës do të ulen gjatë viteve 2019-2020

PRISHTINË, 29 PRILL - Banka Botërore ka rishikuar me ulje çmimet globale të naftës për vitin 2019 dhe 2020, respektivisht me -3.4 dhe -1.5 për qind në raportin periodik për pritshmërinë e çmimeve të mallrave kryesore, i publikuar këto ditë.

Çmimet e naftës pritet të jenë mesatarisht 66 dollarë për fuçi në 2019-n dhe 65 dollarë në 2020-n. Këto vlera janë 8 dhe 4 dollarë respektivisht më të ulëta sesa parashikimet e vjeshtës që Banka Botërore publikoi gjatë tetorit 2018.

Rishikimet me rënie pasqyrojnë gjetjet për rritje më të dobët për ekonominë globale këtë vit. Parashikimi supozon se shkurtimi i prodhimit nga "OPEC" dhe partnerët e tjerë prodhues do të amortizohet nga kërkesa më e ulët



globale, sidomos India, Kina, Shtetet e Bashkuara dhe nga politikat mjedisore që do ta frenojnë konsumin.

Prodhimi global i naftës ra

ndjeshëm në tremujorin e parë të vitit 2019, pas një rritje të madhe në gjysmën e dytë të vitit 2018.

OPEC-ja dhe partnerët e saj ulën ndjeshëm prodhimin, ndërkohë

që prodhimi ra ndjeshëm në Iran dhe Venezuelë.

Prodhimi i naftës në ShBA u rrit me ritmin më të shpejtë të regjistruar ndonjëherë në vitin 2018, duke kontribuar në një rritje të theksuar të eksporteve.

Ndërsa rritja globale në vitin 2019 pritet të jetë më e dobët sesa parashikimi paraprak, megjithëse dobësia do të jetë e përkohshme. Pas vitit 2020, rritja e konsumit të naftës nga OECD do të jetë e papërfillshme sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA). Efikasiteti i politikave mjedisore do ta ulë konsumin e naftës, veçanërisht në sektorin e transportit, teksa rritja e konsumit nga vendet jo-OECD pritet mesatarisht rreth 2 për qind në vit për pesë vjetet e ardhshëm.

Prodhimi global i naftës ra në

tremujorin e parë të vitit 2019, pas një rritje në tremujorin paraardhës.

OPEC-ja dhe partnerët e tij pritet të vendosin nëse do t'i zgjasin afatet për ta mbajtur të frenuar prodhimin në takimin e qershorit. Por kufizimet e lëvizjes së automjeteve në qytetet e mëdha po amortizojnë efektet që sjell ulja e prodhimit.

Për ndryshim nga nafta, çmimet e metaleve pritet të rriten më 2019 dhe 2020-n pas një rënie të mprehtë në gjysmën e dytë të vitit 2018. Çmimet e produkteve bujqësore pritet të bien për 2.6 për qind në vitin 2019 për shkak stokeve të larta. Në vitin 2020 çmimet pritet të rriten me 1.7 për qind si pasojë e pakësimit të mbjelljeve në ShBA dhe kostot më të larta të energjisë dhe plehrave. (monitor.al)

Rriten rastet e falsifikimit të parasë

PRISHTINË, 29 PRILL - Rastet e falsifikimit të parasë kanë shënuar rritje në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e fundvitit 2018. Nga 55 raste sa ishin në dhjetor të vitit 2018, në janar ishin 67 raste.

Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Daut Hoxha, ka bërë me dije për "Kp" se dhjetori i vitit të kaluar është mbyllur me 55 raste të falsifikimit të parasë, kurse këtë vit janari me 67 raste, për të shënuar një rënie të vogël në muajin shkurt, me 61 raste të falsifikimit të parasë.

Në përgjigjen e Policisë së Kosovës lidhur me këtë çështje, bëhet me

dije se ky institucion ka realizuar një numër të madh të aktivitetëve policore kundër veprave penale, përfshirë edhe ato që, sipas Kodit Penal, cilësohen "falsifikim i parasë". "Në dhjetor janë 55 raste të falsifikimit të parasë, në janar 67 raste dhe në shkurt 61. Në këtë kontekst, ne kemi realizuar edhe një numër të aktivitetëve policore edhe kundër veprave penale që, sipas Kodit Penal, cilësohen 'Falsifikim i parasë' dhe mund të konkludojmë se si rezultat i këtyre përpjekjeve operationale janë konfiskuar dëshmi relevante dhe personat e dyshuar të përfshirë në raste të tilla, në konsultim me

organet kompetente të drejtësisë, janë trajtuar në përputhje të ligjeve të aplikueshme", ka thënë Hoxha. Ai ka folur edhe për përkushtimin e Policisë së Kosovës për mirëqenien e qytetarëve të vendit. "Policia e Kosovës, në funksion të realizimit të detyrave dhe autorizimeve ligjore, ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme për zbatimin e planeve policore, luftimin e dukurive negative, krimin organizuar si dhe reduktimin e aktivitetëve ilegale në përgjithësi, të cilat mund të ndikojnë edhe në mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës", është shprehur ai.





Nisma në Prizren: Reagimet e PDK-së në adresë të DKRS-së nxisin përçarje ndëretnike

PRIZREN, 29 PRILL (ER) - Dega e Nismës Socialdemokrate në Prizren ka reaguar ndaj kritikave të PDK-së dhe të AAK-së në adresë të Drejtorisë së Kulturës dhe Rinisë dhe Sportit (DKRS), e cila drejtohet nga Nisma. Kjo degë ka thënë se këto reagime janë "klithmat" e PDK-së dhe zëri i partikularit "papagallit" të AAK-së. "Reagimet që kanë të bëjnë me politikën e DKRS-së, e që menaxhohet nga përfaqësuesi i Nismës, Dega e Nismës në Prizren mendon se është reagim i paarsyeshëm në mungesë të një opozitarizmi real. DKRS-ja në Prizren duke pasur qasje më ndryshe nga qeverisja e kaluar, mbështeti aktivitetet kulturore, sportive dhe OJQ-të e të gjitha komuniteteve pa dallim si: shqip-

tarë, turq, boshnjakë, RAE, etj., duke mos iu imponuar dhe diriguar se si të veprojnë me subvencionet e fituara, por që në të njëjtën kohë duke i respektuar praktikën e të gjithë përfituesve të subvencioneve, të cilët në shenjë respekti reklamojnë logon e sponsoruesit, e që në këtë rast, si dhe në shumë raste të tjera, është Komuna e Prizrenit", është thënë në reagimin e Degës së Nismës Socialdemokrate në Prizren. Sipas kësaj dege, reagimet nga opozitët politikë opozitarë në Komunën e Prizrenit rreth projektit të subvencionuar nga komuna "një kafe turke", më së paku i ngjasojnë një opozitarizmi dhe se reagimet e tilla, veçanërisht nga PDK-ja, nxisin përçarje ndëretnike në qytetin

e Prizrenit, qytet ky që shquhet për multietnicitetin dhe multikulturalizëm. "Aq më shumë kur PDK-ja për sa vjet të qeverisjes së saj në Prizren ka bashkëqeverisur DKRS-në, e që këtë drejtori e kanë udhëhequr minoritetet, por për të cilën neve asokohe nuk na ka lënë përshtypje, marrë parasysh mozaikun etnik e kulturor në qytetin tonë. Logjika primitive e të bërit politikë mbi bazat e ndasive etnike nuk çon askund tjetër përveçse drejt një humnere të thellë dhe këtë përjetim të dhimbshëm qartazi e ka përjetuar PDK-ja në Prizren në zgjedhjet e fundit komunale", është thënë në këtë reagim të Nismës në Prizren, e cila drejtohet nga deputeti Zafir Berisha.

Punëtorët teknikë të Prishtinës padisin komunën

PRISHTINË, 29 PRILL - Punëtorët teknikë të disa shkollave të Prishtinës, punëtorët e sigurimit dhe të qendrave mjekësore e familjare të Prishtinës, kanë filluar procedurat për ngritje të padisë ndaj Komunës së Prishtinës. Kjo padi është bërë si rezultat i mosrespektimit të vendimeve që kanë marrë kërret e Prishtinës për këtë kategori të punëtorëve. Këta punëtorë janë duke kërkuar të kthehen nën menaxhim të Komunës së Prishtinës dhe pagesën e katër-përqindëshit, ashtu siç u është premtuar nga kryetari Shpend Ahmeti.

Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, në një inter-

vistë për "Kosovapress", ka thënë se grevën e paralajmëruar për këtë javë e kanë anuluar pasi që kanë në proces padi për komunën. Ai ka paralajmëruar grevë në momentin kur do të jetë e nevojshme prania e këtyre punëtorëve nëpër shkolla dhe institucione shëndetësore. Duke folur për gjendjen e punëtorëve teknikë të shkollave dhe qendra mjekësore të Prishtinës, Azemi ka thënë se atyre po u mohohet e drejta për t'i marrë përfitimet që ua jep edhe Ligji i punës. Azemi e ka akuzuar të parin e kryeqytetit, Shpend Ahmetin, se problemet e Prishtinës i ka vendosur në rend të dytë dhe më shumë po bën marketing politik.



Jashari inspektion punimet në disa rrugë të qytetit të Skenderajt



SKENDERAJ, 29 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka inspektuar të hënën punimet që janë duke u bërë në kuadër të asfaltimit të rrugës në lagjen e katërt të kësaj komune dhe në disa pjesë të tjera të qytetit. "Edhe pak punë deri të finalizimi i asfaltimit të rrugës e cila është lënë në harresë për

shumë vjet, që çon në kompleksin sportiv ku, duke e realizuar këtë projekt, përfitojnë banorët e lagjes IV rrugë të asfaltuar si dhe kompletohet infrastruktura përcjellëse e kompleksit të vetëm sportiv në komunën tonë. Ritëm i njëjtë i punimeve në rregullimin e infrastrukturës së brendshme të qytetit po vazhdon edhe

mbrepa objektit të Qendrës së Kulturës 'Hasan Prishtina', që lidhet me rrugën 'Ilaz Kodra', me çfarë qarkullimi i veturave do të bëhet pa vështirësi, ndërkohë që edhe këmbësorët do ta kenë trotuarin, skaj të cilit do të mbillen edhe drunjt dekorativë", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Sindikalistët e shërbyesve civilë të Vushtrrisë vizitojnë Strugën

VUSHTRRI, 29 PRILL (ER) - Punëtorët e Sindikatës së Shërbyesve Civilë nga Vushtrria janë duke qëndruar

në Strugë në një ekskursion treditör. Me këtë rast, ata i ka vizituar kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, së

bashku me kryetarin e Strugës, Ramiz Merko. Ramadan Kutllovci, kryetar i kësaj sindikate, ka falënderuar

kryetarin Tahiri dhe kryetarin Merko për vizitën që ua kanë bërë sindikalistëve të shërbyesve civilë të Vushtrrisë.



Filozofia dhe etika politike e Ukshin Hotit (2)



Prof. dr. Sabri
KİÇMARI

Republika Popullore e Kinës, sipas tij, e luan rolin e fuqisë së madhe në marrëdhëniet ndërkombëtare jo pse i plotëson atributet e lartpërmendura, por vetëm me numrin e madh të popullsisë dhe madhësinë territoriale. Kjo gjendje në vitin 2019 ka ndryshuar. Republika Popullore e Kinës, përpos që paraqet shtetin me popullsinë më të madhe në botë dhe njërin nga shtetet me territorin më të madh gjeografik, që nga viti 2010 zë vendin e dytë në botë për nga fuqia ekonomike (IMF 2019).

Nocioni "Luftë e Ftohtë", sipas Ukshin Hotit, u vu në përdorim të përditshëm pas Luftës së Dytë Botërore, përmes të cilit përshkruhej "një situatë tendosjeje ndërmjet fuqive të mëdha me sistem të ndryshëm shoqëror-politik" (Hoti 1976: 14). Në të vërtetë, "Lufta e Ftohtë" paraqet konfliktin në mes të shteteve perëndimore nën udhëheqjen e SHBA-së dhe të ashtuquajturit Bllokut të Lindjes, nën udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik, i cili zgjati në mes të viteve 1947-1989. Edhe pse gjatë kësaj periudhe nuk erdhi deri te konflikti i armatosur në mes të dy blloqeve, ky konfrontim shfaqej si një lloj lufte ideologjike në mes të demokracisë liberal-demokratike dhe real-socializmit, si luftë sistemore shoqërore-ekonomike në mes të ekonomisë së tregut të lirë dhe ekonomisë së dirigjuar nga shteti si dhe si luftë për fuqi ushtarake në mes të Traktatit të NATO-s dhe Paktit të Varshavës. Konflikti në mes të dy blloqeve ka pasur në radhë të parë natyrë filozofike politike: dy stile të ndryshme politike, dy sisteme të ndryshme ideologjike, dy botëkuptime të ndryshme filozofike për botën, shtetin, shoqërinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Ndryshe nga disa teoricienë perëndimorë, të cilët "marrëdhëniet ndërkombëtare, në esencë, i shpjegonin me ekuilibrin e fuqive", dhe fuqia në kohë paqeje, sipas tyre, "shfaqej si prestigj", me qëllim të fshehjes së karakterit të saj të vërtetë, Hoti konstaton se lufta e ftohtë në esencën e vet, "është vetëm formë e zbatimit të dhunës jo vetëm në kuptimin fizik, por edhe në atë psikologjik, ekonomik, politik dhe shoqëror" (Hoti 1976: 36). Ai polemizon edhe me autorët e proveniencës lindore, të cilët insistojnë se Lufta e Ftohtë ka karakter klasor, përkatësisht është një "formë e luftës ndërkombëtare klasore". Hoti konstaton se është "bukur vështirë të përcaktohet karakteri klasor i politikës së "Luftës së Ftohtë", meqë asnjëherë nuk ka ekzistuar dallimi

i qartë ndërmjet politikës praktike të ndonjë vendi, pa marrë parasysh sistemin e tij politik dhe qëllimet e tij të deklaruara" (Hoti 1976: 15).

Duke mbajtur një qëndrim drejtpeshues në analizën e tij, Ukshin Hoti i vë në tavolinë tezat e të dy sistemeve kundërthënëse ideologjike, politike dhe ushtarake. Ai ja ofron lexuesit këndvështrimin perëndimor për Bashkimin Sovjetik, duke cituar përfaqësuesin më eminent të teorisë së realizimit në marrëdhëniet ndërkombëtare Hans Morgenthau, i cili shkruan se "ideologjia socialiste ishte tërheqëse për njerëzit në deceniet e para të shekullit XX vetëm si mit, e jo si realitet" (Morgenthau 2011: 9). Sipas Morgenthau "ajo që, në të vërtetë, i kërcënohet Perëndimit, nuk është miti komunist, por forca e Ruisë". (Morgenthau 2011: 9). Pra, shohim se Morgenthau e përqendron vëmendjen te forca dhe jo te ideologjia si mit. Në të njëjtën kohë, Hoti dekonstruktiv teorisht edhe linjat vepruese të Stalinit në politikën e jashtme. Ai konstaton se Stalini "interesat ideologjike të proletariatit ia nënshtrohte politikës shtetërore sovjetike, ndërsa ideologjinë e shndërroi në instrument të kësaj politike" (Hoti 1976: 16). Sipas tij "Stalini gjithnjë shërbeu me fjalor revolucionar të marksizmit klasik, por në të shumtën e rasteve ndiqte interesin e politikës së shtetit të vet" (Hoti 1976: 16). Pra, jo ideologjia, por në radhë të parë interesi shtetëror, jo revolucionari marksist, por interesi, ishin linjat e veprimit të Stalinit në marrëdhëniet ndërkombëtare.


Stili mprehtë analitik i Hotit vërehet edhe në analizën e konfliktit në mes të SHBA dhe Republikës Popullore të Kinës. Sipas tij "Shtetet e Bashkuara ndaj RP të Kinës, zbatonin metodën e zhonglerizmit politik" (Hoti 1976: 34). SHBA nuk pranonin që Republika Popullore e Kinës të anëtarësohej në OKB, duke u arsyetuar se qeveria e Kinës kontinentale nuk përfaqëson popullin kinez, por Taivani është përfaqësues legjitim i tij. SHBA do të bllokoni pranimin e Republikës Popullore të Kinës deri në vitin 1971. Megjithë gjuhën e ashpër në mes të SHBA dhe Republikës Popullore të Kinës, të dy palët u kujdesën që të shtensiononin situatën, sidomos pas ardhjes së Richard Nixonit në krye të Administratës së SHBA.

Sipas Ukshin Hotit politika e koekzistencës paqësore në kontinentin e Evropës gradualisht u shndërrua në politikë të detantit, e cila implikonte "klimë të re, atmosferë më të butë të marrëdhënieve ndërkombëtare, ton më miqësor dhe mundësi më të mëdha për bashkëpunim, që do të jetë shtytje për zhvillim më të madh teknik-teknologjik dhe ekonomik" (Hoti 1976: 72). Një rol të madh në këtë drejtim ka luajtur Ost-Politika e kancelarit gjerman Wili Brandt.

Ukshin Hoti e rreshton veten natyrshëm në mbështetës të demokratizimit dhe barazisë në

marrëdhëniet ndërkombëtare si dhe në mbështetës të lëvizjeve nacionalçlirimtare, duke u deklaruar kundër privilegjeve të shteteve të mëdha në marrëdhëniet ndërkombëtare, kundër të drejtës për eksportim të revolucionit ose kundërrevolucionit si dhe kundër kufizimit të sovranitetit të shteteve të pavarura.

Në analizën e mëvonshme të rrethanave të krijuara në prag të përfundimit të Luftës së Ftohtë Ukshin Hoti e definon sistemin e ri ndërkombëtar si policentrist. Sipas tij polet e policentrizmit kanë këtë strukturë: "Polet e këtij policentrizmi janë të pajisura me lloje të ndryshme të fuqisë ushtarake (Sovjetikët), ekonomike dhe financiare (Japonezët dhe Gjermanët), demografike (Kina dhe India), ushtarake dhe ekonomike (SHBA)" (Hoti 1995: 52). Lufta e Ftohtë përfundoi në një kontekst interesant ndërkombëtar. Në lidhje me përfundimin e



saj, Henry Kissinger ka shkruar: "Lufta e Ftohtë kishte filluar në një kohë, kur Amerika priste një periudhë paqeje dhe përfundoi në një moment, kur Amerika po përparonte për t'i bërë ballë një periudhe të re konflikti të zgjatur" (Kissinger 1999: 762). Ky sistem do të lëvizte në drejtim të ndërlidhjes së natyrës anarkike të shteteve nëpërmjet "një rrjeti të gjerë të strukturave ligjore dhe të rendit ndërkombëtar" (Kissinger 2014: 16), gjë që do të shtrojë nevojën e domosdoshme për reformimin dhe modernizimin e tij konform rrethanave të reja të krijuara.

1. Pikëpamjet për politikën e jashtme

Studiuesi i njohur i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Karl Deutsch, e ka definuar në këtë mënyrë politikën e jashtme: "Së pari, politika e jashtme e çdo vendi merret me ruajtjen dhe sigurimin e pavarësisë së vendit dhe, së dyti, me ndjekjen dhe mbrojtjen e interesave të tij ekonomike" (Deutsch 1978: 100). Edhe përfaqësuesi tjetër i shkollës realiste në marrëdhëniet ndërkombëtare, Hans Morgenthau, në analizën e tij rreth parimeve të politikës së jashtme e vendos fokusin te interesi dhe fuqia (Morgenthau 2011: 33). Ai e quan krejt të kotë dhe utopike të kërkohet çelësi i politikës së jashtme vetëm në

motivët e shtetarit (Morgenthau 2011: 6).

Në pikëpamjet e Ukshin Hotit për politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare ne gjejmë jo vetëm një mendje të mprehtë analitike, por edhe përfaqësuesin tipik të shkollës realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në linjë me dy klasikët e mendimit shkencor të marrëdhënieve ndërkombëtare, Ukshin Hoti politikën e jashtme e definon "si kompleks metodash për realizimin e interesave të shtetit dhe shprehje e shtetësisë së shtetit apo e sovranitetit të kombit" (Hoti 1995: 20). Ai shkruan se "ideja e interesit është vërtetë në thelb të politikës dhe se nuk dëmtohet nga koha dhe hapësira" (Hoti 1995: 25). Politika e jashtme mbështetet mbi një shumëllojë të caktuar të determinantave "duke përfshirë traditën historike të shtetit, lokacionin gjeografik, interesat dhe qëllimet nacionale dhe nevojat e sigurimit"

caktuara për mbrojtjen e interesave nacionale. Do të duhej të lindte Ushtria Çlirimtare e Kosovës që të vërtetonte katërçipërisht konceptet e tij.

Ukshin Hoti i kritikon ashpër konceptet lideriste dhe bajraktariste në të konceptuarit e politikës së jashtme. Vërejtjet e tij duken tepër aktuale edhe për kohët e sotme. Ai kritikon "botëkuptimin tradicional dhe rudimentar" mbi politikën e jashtme, "nëse jo edhe primitiv, mjaft të përhapur në disa qarqe me rëndësi politike në Jugosllavi, por edhe në Kosovë, i cili u përgjigjej ambicieve lideriste në të gjitha nivelet apo mentalitetit të thjeshtësuar bajraktarit" (Hoti 1995: 20).

Hoti nuk ngurron të luajë rolin e këshilltarit për burrështetasit në lidhje me interesat strategjike nacionale: Çdo burrështeti që kërkon t'i formulojë qëllimet e politikës së jashtme dhe t'i realizojë ato në praktikë, doemos duhet t'i marrë parasysh "disa kufizime të palëvizshme" që i nënkuptojnë determinantat në fjalë. Pavarësisht nga bindjet filozofike, politike apo religjioze të individëve "ekzistojnë interesa të gjerë strategjike të lidhur intimisht me pozitën gjeografike të kombit dhe me rolin ndërkombëtar që duhet ruajtur" (Hoti 1995: 20).

Elita politike në Kosovë nuk e kishte konceptuar me realizëm politikën ndërkombëtare në fund të viteve 1980 dhe 1990. Ajo e kishte përjetuar Bashkimin e Gjermanisë "si fitore të gjermanizimit të mundshëm të Evropës e jo si evropëzim i Gjermanisë; politika globale amerikane u përjetua si antisllavizëm i theksuar, kurse rënia e Bashkimit Sovjetik gati u barazua me eliminim total të faktorit sllav nga skena politike e Evropës dhe e botës" (Hoti 1995: 107). Bazuar në këtë konceptim jorealit, sipas Hotit, politika jonë e jashtme u orientua në mbështetjen e tepruar, gati ekskluzive, të faktorit të jashtëm: prej ekskluzivitetit të mendimit, njëlloj topitjeje të elanit të lëvizjes, e gjer te urrejtja latente dhe potenciale e bartësve të ndryshëm të mendimeve të kundërta.

Studiuesit e politikës së jashtme të Kosovës mund vetëm të aplaudojnë vërejtjet intencionale të Ukshin Hotit. Dhe mund të shtojnë edhe diçka: Politika jonë e jashtme duhet ta studiojë mendimin e Ukshin Hotit. Ka çfarë të mësojë prej tij, në mënyrë që të shmangë zvetënimin në veprim dhe përfaqësim, i cili ka arritur një shkallë të lartë joprofesionalizmi dhe inefficiencë. Politika jonë e jashtme duhet të heqë dorë për t'ju dhënë kompetencavendimmarrëse njerëzve joprofesionistë dhe pa mbështetje qytetare, përkundër mësymjes së tyre të përbindshme, duke pasur parasysh kapitalin e saj potencial, për ta shfrytëzuar për përfitime lideriste, partiake dhe financiare-biznesore. Interesi nacional, interesi shtetëror dhe konsensusi për to duhet të jenë premissat e veprimit në fushën e politikës së jashtme. (Vijon)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



Bideni nis fushatën presidenciale në Pitsburg

WASHINGTON, 29 PRILL - Ish-nën-presidenti amerikan Joe Biden ka zhvilluar të hënën takimin e tij të parë si kandidat për president në Pitsburg të Pensilvanisë. Ai ka mbajtur një fjalim përpara anëtarëve të sindikatave, mbështetja e të cilëve mund të jetë kyçe në garën për t'u bërë kandidati zyrtar i demokratëve për zgjedhjet presidenciale të 2020-s. Biden, i cili iu bashkua garës javën e kaluar, i sheh organizatat e punëtorëve si pjesë të rëndësishme për të siguruar përkrahje. Por, pavarësisht prej lidhjeve të tij

të gjata me sindikatat, kjo gjë mund të mos jetë dhe aq e lehtë. Në radhët e demokratëve llogariten 20 kandidatë, shumë prej të cilëve kërkojnë mbështetjen e sindikatave. 76 vjeçari Joe Biden e ka cilësuar veten si përkrahës të sindikatave, por puna e tij si senator dhe dy mandate në detyrën e ish-nën-presidentit gjatë administratës Obama mund t'ia komplikojnë përpjekjet për t'i tërhequr votuesit e sindikatave. Në detyrën e tij si senator i shtetit të Delauearit, Bideni mbështeti marrëveshjen e Tregtisë së Lirë

për vendet e Amerikës Veriore, të njohur ndryshe si NAFTA, e cila u bë një pikë mosmarrëveshjeje me sindikatat, sipas të cilave, ajo u bë shkak që amerikanët të humbasin vende pune. Ndërkohë Shoqata Ndërkombëtare e Zjarrfikësve njoftoi se mbështet zotin Biden si kandidat demokrat për president. Bideni mban rekordin mes kandidatëve demokratë për sigurimin e fondeve për fushatën e tij. Vetëm në 24 orët e para ai siguroi 6,3 milionë dollarë për fushatën.



Socialistët fitojnë zgjedhjet në Spanjë, ndonëse rritet ekstremi i djathtë

Socialistët e udhëhequr nga kryeministri aktual Pedro Sanchez kanë fituar 29 për qind të votave, përkatësisht 123 ulëse në Kongresin me 350 deputetë, kurse Partia Vox e ekstremit të djathtë ka fituar 10 për qind të votave, që i mundëson kësaj partie të përfaqësohet nga 24 deputetë

MADRID, 29 PRILL - Socialistët e qendrës së majtë në Spanjë kanë fituar zgjedhjet e përgjithshme të dielën, mirëpo duhet ta fitojnë edhe përkrahjen e partive më të vogla në mënyrë që të mbesin në pushtet. Ky proces zgjedhor ka rezultuar edhe me rritjen e përkrahjes për partinë e ekstremit të djathtë, e cila ka fituar ulëse në Dhomën e Ulët të Parlamentit për herë të parë në katër dekada. Me 99 për qind të votave të numëruara, socialistët e udhëhequr nga kryeministri aktual Pedro Sanchez kanë fituar 29 për qind të votave, përkatësisht 123 ulëse në Kongresin me 350 deputetë. Partia Vox e ekstremit të djathtë ka fituar 10 për qind të votave, që i mundëson kësaj partie të përfaqësohet nga 24 deputetë. Sanchez ka njoftuar se shumë shpejt do t'i nisë bisedimet me parti të tjera politike, duke i thënë publikut në qendër të Madridit se "e ardhmja ka fituar dhe e kaluar ka humbur". Ai ka lënë të kuptohet se preferon të bashkëpunojë me aleancën e krahut të majtë dhe, po ashtu, ka nisur një paralajmërim për separatistët katalanë, për

përkrahjen e të cilëve mund të ketë nevojë, që çfarëdo marrëveshje pas zgjedhjeve duhet ta respektojë Kushtetutën e vitit 1978, e cila ndalon ndarjen e rajoneve. "Kushti i vetëm është që të respektohet Kushtetuta, të vazhdojmë përpara drejt drejtësisë shoqërore, bashkekzistencës dhe politikës së pastër", ka thënë Sanchez, teksa ka përmendur kushtet për të punuar me partitë e tjera. Suksesi i partisë Vox i ka kushtuar partisë konservatore, Partia Popullore, me 66 ulëse më pak sesa në zgjedhjet e vitit 2016, transmeton agjencia "Associated Press". Votuesit në Spanjë kanë qenë së fundmi të zhgënjyer, pasi shteti i tyre është përballur me recession, skandale të korrupsionit, kërkesa për ndarje dhe pavarësim të Katalonjës dhe rritje të nacionalizimit të së djathtës ekstreme, i cili nuk është parë prej kur ka përfunduar regjimi i diktaturës në Spanjë në vitet 1970. "Ne iu kemi treguar se ne do të fillojmë ta rikthejmë Spanjën dhe kjo është ajo që kemi bërë", ka thënë lideri i partisë Vox, Santiago Abascal, duke iu referuar një fushate të



shekullit të 15-të të udhëhequr nga Mbretëria katolike spanjolle për t'i dhënë fund sundimit islamik në Gadishullin Iberik. Vox, parti e themeluar pesë vjet më parë, ka premtuar që ta mbrojë Spanjën nga "armiqtë" duke përmendur feministët, elitat liberale dhe myslimanët. Me rritjen e kësaj partie janë rritur edhe ndasitë politike në

Spanjë, e cila është udhëhequr për dekada nga socialistët dhe Partia Popullore. Për të qëndruar në pushtet, socialistët dhe Sanchez duhet të formojnë koalicion qeveritar me partitë e vogla, përfshirë partinë e ekstremit të majtë, Të Bashkuar Mundemi, të udhëhequr nga Pablo Iglesias. Iglesias ka thënë pas votimit se

ai do të "dëshironte një rezultat më të mirë, mirëpo kanë arritur mjaftueshëm për ta ndaluar krahun e së djathtës", duke ofruar prej tani mbështetje për Sanchezin. Dalja në këto zgjedhje ka qenë rreth 76 për qind, apo rreth 8 për qind më shumë sesa në zgjedhjet e mbajtura më 2016. (rfe)

Polemika në Itali, një kandidate myslimane për zgjedhjet lokale

ROME, 29 PRILL - Nasri Assiya, 20 vjeçe, do të kandidojë si këshilltare e qytetit në zgjedhjet e ardhshme lokale më 26 maj në Montoro, në provincën e Avellinos. Kundër eksponentes të Lëvizjes 5 Yjet, e cila mban burkën siç kërkohet nga tradita e vendit të saj të origjinës, ka pasur qindra mesazhe në "Facebook" dhe

"Instagram" që e ftojnë atë të heqë dorë. Në fakt, ka komente të shumta nga ata që nuk ndajnë angazhimin politik të gruas myslimane, nën postin që shpall kandidaturën e saj. "Ajo është Nasri Assiya, është 20 vjeçe dhe e diplomuar në matematikë. U regjistrua në Universitet kur ishte vetëm 17 vjeçe, një mirë katër gjuhë

të huaja", thuhet në mesazhin zgjedhor të kandidates. Assiya dëshiron të marrë pjesë në ndryshim dhe të drejtojë të ardhmen e saj dhe të shumë të rinjve të Montoros, duke u angazhuar në mënyrë që Montoro mund të vrapojë drejt një të ardhmeje sociale, ekonomike, kulturore dhe të zhvillimit të punës.



'Libri i luftës' vlerësohet lart nga bashkëkombësit tanë në Zvicër

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Pas promovimit në Kosovë, këto ditë "Libri i luftës" i gazetarit dhe publicistit Nuhi Bytyçi po promovohet edhe në Zvicër, Austri dhe Slloveni. Të dielën ky libër u prezantua edhe në restorantin "Centrum 68" në Wyrenlos afër Cyrihut, ku në organizim të Konsullatës së Republikës së Kosovës në Cyrih morën pjesë shumë bashkatdhetarë nga të gjitha viset etnike shqiptare.

"Libri i luftës", me memoaret e Bytyçit, po pritet me interesim të madh nga bashkatdhetarët tanë në këto vende ngaqë në të, përveç ngjarjeve historike në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare, është përfshirë edhe kontributi i diasporës shqiptare në të gjitha proceset, e veçmas gjatë periudhës së luftës për liri, pavarësi të Kosovës dhe të drejtat e plota kombëtare.

Lidhur me përmbajtjen e "Librit të luftës" të paraqitura nga shefi i Misionit Diplomatik të Kosovës në Cyrih, Sami Kastrati dhe veprimtarët dhe publicistët Ibish Neziri e Vaxhid Sejdiu, e vlerësuan me tone pozitive angazhimin

skenën kulturore, por edhe atë politike të Kosovës, duke filluar nga fillet e pluralizmit politik dhe deri te drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një libër ku ngjarjet dhe personazhet përbëjnë pjesën e historisë më të re të popullit shqiptar dhe këndvështrimi i autorit prek ndjenjat e lexuesit. Vlen të theksohet se autori ngjarjet dhe personazhet i përshkruan në mënyrë të thjeshtë, pa hiperbolizime, por ashtu siç ishin realisht ndarjet dhe kundërshtitë brenda shqiptare. Autori është i drejtpërdrejtë, ngjarjet i radhitë në bazë të zhvillimeve dhe rëndësisë që kanë, duke i shkruar në formën e shënimeve si bisedat private, si takimet dhe përpjekjet për t'i realizuar takimet në fjalë. Personazhet janë realë, të mbështjellë me fakte, ashtu siç janë radhitur edhe pesë albume me qindra e qindra fotografi, të cilat faktojnë ngjarjet dhe personazhet e kohës. Libri shoqërohet me data, me emra dhe ngjarje të ndryshme të cilat janë shumë të prekshme, veçanërisht për ata të cilët kanë



si lulja pa ujë", ka thënë ai.

Nga ana e tij, veprimtari i çështjes kombëtare, Ibish Neziri, ka theksuar: "Këtë herë Nuhiu mes nesh nuk vjen as si kronist televiziv e as si autor filmash dokumentarë që jemi mësuar ta shohim në 22 vjetët e fundit, por vjen si autor me librin e tij të parë të titulluar 'Libri i luftës', libër voluminoz sa iu për-

vetveten, duke u bërë një telekronist i shkëlqyeshëm i kësaj lufte. "Nuk la pothuajse asnjë fushë-betejë e asnjë zonë operative ushtarake pa e vizituar e pa raportuar nga ajo. Pra, me fillimin e luftës autori i këtij libri kalon në terren dhe shumë shpesh paraqitet herë nga një front lufte e herë nga një tjetër front, herë nga njëra zonë e herë nga zona tjetër, me biseda e intervista me komandantë e udhëheqës të luftës", ka thënë Neziri për "Librin e luftës". Nga ana e tij, autori i "Librit të luftës" gazetari dhe publicisti Nuhi Bytyçi, duke shprehur mirënjohje për kontributin e mërgatës shqiptare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ka theksuar se mërgata jonë luajti rol të rëndësishëm për organizimin e gjithanshëm të rezistencës së armatosur kundër pushtimit serbo-sllav, iu përgjigj kushtrimit të atdheut për mobilizim për liri e pavarësi.

Për "Librin e luftës" folën edhe Sylë Arifi, Riza Demaj, Rexhep Rifati, Sylejman Beqa, Bajram Mulaj, Fatmir Beka, Rrustem Mehmeti e pjesëmarrës të tjerë i bënë një vlerësim të gjithanshëm veprës publicistike të Nuhi Bytyçit, duke e çmuar si thesar të rëndësishëm për historinë tonë më të re kombëtare. Me këtë rast, u zhvillua një bashkëbisedim mes pjesëmarrësve të promovimit dhe autorit të librit, Nuhi Bytyçi, lidhur me përmbajtjen, sidomos me sfidat e tij dhe përkushtimin për prezantimin e një mori ngjarjesh të rëndësishme në të gjitha hapësirat etnike shqiptare. "Libri i luftës" të hënën është promovuar edhe në Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Gjenevë, kurse në Austri do të promovohet më 1 maj në orën 19:00 në Knittenfeld afër Gracit, ndërkaq më 3 maj në orën 18:00 në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Vjenë dhe më 5 maj në Slloveni.



shumëvjeçar të gazetarit dhe publicistit shqiptar Nuhi Bytyçi në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Samir Kastrati, ish-gazetar dhe tani shef i misionit diplomatik të Kosovës në Cyrih, ka potencuar rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të gazetarit dhe publicistit Nuhi Bytyçi gjatë 40 vjetëve të fundit, i cili, si tha ai, në vazhdimësi ishte në luftë për ta plasuar të vërtetën për Kosovën dhe popullin shqiptar.

Vaxhid Sejdiu në vlerësimin e tij potencoi se "'Libri i luftës' në tërësi është i thurur mbi ngjarjet dhe personazhet reale të kohës, të cilët ende janë aktualë jo vetëm në

qenë dhe janë aktorë të zhvillimeve politike në Kosovë dhe më gjerë", ka pohuar Sejdiu.

Ai përkujtoi bashkatdhetarët se lexuesi njihet me fakte reale nga zonat e luftës, luftëtarët e lirisë, lufta titanike e UÇK-së përballë pushtuesit serb, dëshmorët e kombit etj. "Epilogu i këtij libri natyrisht na del në mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, përballë kurtheve të ndryshme dhe përpjekjet e tij si gazetar, për të anuar në shërbim të fjalës së lirë, lirisë dhe atdheut, të cilat mund të krahasohen me thënien e Sami Frashërit 'Liria është ushqimi i shpirtit dhe i mendjes. Atje ku nuk ka liri, shpirti dhe mendja vyshken

ket faqeve - 767 faqe, por edhe temave që i trajton. Dhe, me të drejtë, pos libër i luftës, mund të quhet edhe libër i jetës, ngaqë në të autori i sjell kujtimet e një periudhe rreth 50-vjeçare", ka thënë Neziri.

Më tej, ai ka shtuar se titullin "Libri i luftës" e arsyeton përmbajtja ngaqë në secilin kapitull, e në secilën faqe ka përballje lufte. "Për autorin lufta nuk ka filluar në vitin 1998 sikur për shumë njerëz të tjerë, por shumë më herët se këtë vit", ka thënë Neziri. Ai ka shtuar se nga kapitulli i gjashtë, përmes kujtimesh, autori e trajton luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në shërbim të së cilës krejtësisht e vë



BOTA E PËRTEJME E HARUKI MURAKAMIT (2)

Shkrimtari në këtë intervistë flet për stilin dhe procesin e të shkruarit si dhe për vendet e çuditshme e të errëta të cilat i hedh në letër

Intervistoi: Deborah
TREISMAN

Treisman: Çfarë ju shtyri t'i kundërviheshit tërmetit me fikcion dhe sulmit me gaz me gazetari?

Murakami: Për shkak se Kobe është qyteti im i lindjes ishte diçka që më prekte në loçkën e zemrës. Meqë i kisha intervistuar ata njerëz, isha shumë i mërziur, shumë i pikëlluar. Por në fikcion mund ta krijoj botën time, andaj është më e lehtë për mua. Dhuna mund ta zhbijojë trurin anë përtej. Mund të presë diçka shumë të rëndësishme. Para tërmetit, ne mendonim se toka ishte e fortë dhe e qëndrueshme por, jo më. Mund të destabilizohet, të jetë e paparashikueshme dhe e butë. Mendoj se kjo është ajo që doja të shkruaja. Pastaj kishte shumë katastrofa të tjera - 11 shtatori, cunami dhe të tjera. E pyeta veten çfarë mund të bëja për njerëzit që kishin vuajtur në ato fatkeqësi. Dhe, thashë: Çfarë mund të bëja është të shkruaj fikcion të mirë. Meqë kur shkruaj një tregim të mirë mund ta kuptojmë më mirë njëri-tjetrin. Nëse jeni lexues dhe unë shkrimtar, nuk ju njoh, por në botën e nëndheshme ka një tunel sekret ndërmjet nesh: ne mund t'i përdorim mesazhet dërguar njëri-tjetrit pavetëdijshëm. Andaj men-

doj se kjo është një prej mënyrave se si mund të kontribuoj.

Treisman: Duke shkruar ju përçoni një mesazh, por si ju kthehet ky mesazh?

Murakami: Nuk e di. Ndoshta do të gjej një çare.

Treisman: Pasi botuat novelën "Kafka në breg", kishit një uebfaqe ku njerëzit mund të shtronin pyetje për veprën tuaj dhe që t'ju thoshin teorinë e tyre për të - dhe ju iu përgjigjet disa prej pyetjeve. Pse iu përgjigjet? Pse e bëtë këtë? Pse bash me atë libër?

Murakami: Isha kureshtar. Ishte për një periudhë të kufizuar, por mora një mal me letra elektronike. Nuk mbaj mend sa sosh - mbase tridhjetë mijë. Po rilexova që të gjitha - desh i qorrova sytë! Dhe, mbase, iu përgjigja tre mijë prej tyre. Ishte punë e rëndë, por ma merr mendja se e mora vesh se çfarë soji njerëzish po lexonin veprat e mia. Disa prej tyre shtronin pyetje palidhje. Njëri prej tyre pyeste për krijesat detare. Dhe ai donte të dinte nëse kishin këmbë dhe duar. Pse më pyeste ai për këtë punë. Përgjigja ime ishte kjo: Vëri dhjetë palë dorëza dhe dhjetë palë çorapë dhe do ta merrni vesh përgjigjen. Nuk e di nëse krijesa detare bën gjumin në shtrat apo jo, por u kënaqa

me shumicën e pyetjeve.

Treisman: Kjo ishte një prej mënyrave për të rënë në kontakt me lexuesit tuaj. Unë e di se ju në Japoni nuk i pëlqeni ngjarjet publike ose diskutimet publike. Pse kështu?

Murakami: Unë jam shkrimtar, dhe të shkruaj në studion time është privilegj i madh për mua. M'u mbush mendja top në një çast se nuk do të bëja asgjë tjetër, pos të shkruaja - ishte vendim që s'e luante topi. Por, së fundi, nisa të prezantoja muzikë të zgjedhur në një radiostacion në Tokio, dhe këtë punë po e bëj tani.

Treisman: Pse e pranuat?


Murakami: Ata më thanë se mund t'i zgjidhje këngët që i dëshiroja dhe të flisja çfarë më pëlqente për pesëdhjetepesë minuta me radhë. Andaj u mendova. Pse jo? Ajo që lëshoj në radiostacion është e stërpërzgjedhur - gjithçka prej Billie Holiday deri te Maroon 5.

Treisman: Mendoj se keni thënë se të jesh shkrimtar në Japoni është paksa diçka që të djegë. Është profesion shumë publik, dhe ju ngulmoni në gjëra të rëndomta. Si i kombinoni këto gjëra?

Murakami: Sinqerisht, në fillim nuk isha aspak i lumtur në botën letrare në Japoni. Isha një autsajder - një dele e zezë, një rishtar në rrjedhën e rrëmbyeshme të letërsisë japoneze tradicionale të rrymës së kohës. Disa njerëz thanë se isha zë i ri në letërsinë japoneze, e disa të tjerë më quajtën punk. Isha disi i hutuar dhe me dy mendje. Nuk kisha haber se çfarë po ndodhte. Ishte si "Lisa në botën e çudirave". Andaj ika nga Japonia dhe dola jashtë vendit. Së pari shkova në Itali dhe Greqi, dhe i kalova dy a tri vjet, pastaj shkrova "Norwegian Wood", dhe njerëzit e urryen atë libër në Japoni.

Treisman: Po, veçse shitët më shumë se dy milionë kopje.

Murakami: U shitën më shumë se



dy milionë kopje, por njerëzit më urrenin, andaj dola prapë jashtë vendit. Shkova në Princeton, New Jersey. Një vend i mrekullueshëm, por i mërziutshëm. Pastaj shkova në Boston në Tufts University. Këtu ishte goxha ndryshe, kështu që ishte e mirë si përvojë.

Treisman: Pastaj, pas tërmetit dhe sulmit me gaz sarin, ndiet se kishte ardhur koha të ktheheshit në Japoni?

Murakami: Më 1995 ndieja se duhej të kthehesha në vendlindje dhe të shihja nëse kishte diçka që mund të bëja për njerëzit. Jo për shtetin, jo për kombin, jo për shoqërinë, por për njerëzit e mi - ky ishte nocioni që e mendoja unë.

Treisman: Si ishte dallimi ndërmjet dy gjërave: ndërmjet vendit dhe popullit?

Murakami: Njerëzit i blejnë librat e mi. Shteti nuk i blen.

Treisman: A e mendoni krijimtarinë tuaj si japoneze, apo më shumë në linjë me traditat letrare perëndimore?

Murakami: Nuk e mendoj ashtu. Tregimet e mia janë të miat. Nuk i përkasin asnjë kategorie tjetër, dhe karakteret e mia, shumica prej tyre, janë japonezë. Andaj mendoj se jam shkrimtar japonez. Stili i veprave të mia nuk i përket askundit, ma merr mendja.

Treisman: Në Japoni mendoj se shumica e lexuesve tuaj në fillim ishin goxha të rinj. Kishit lexueshmëri të madhe ndër të rinjtë.

Murakami: Oh, po, është shumë e çuditshme! Kur nisa të shkruaja lexuesit e mi ishin në të njëzetat dhe në fillim të tridhjetave. Pas dyzetë vjetësh lexuesit e mi janë ende kryesisht në të njëzetat. E mira e kësaj pune është se disa prej adhuruesve të brezit të parë ende po i lexojnë veprat e mia, por edhe bijtë dhe bijat e tyre ende po i lexojnë. Kur tre ose katër persona në një familje lex-

ojnë të njëjtën vepër, jam shumë i lumtur kur marrë vesh. Një mik imi ka fëmijë tinxherë dhe në të njëzetat. Ai thotë se ata zor se flasin më, prindërit dhe fëmijët e tyre. Tema e vetme për të cilën flasin janë veprat e mia.

Treisman: Nëse i dimë lojërat tua me fjalët, se ju pëlqen t'i shikoni pjerrinat, ta zëmë, a na ndihmon kjo që ta çmojmë veprën tuaj?

Murakami: Franc Kafka i donte pjerrinat. Kjo është rrenë e kulluar; e kam sajuar unë. Por, a është e mirë? Ka shumë gjasë që Kafka t'i ketë pëlqyer pjerrinat.

Treisman: Është e mundshme.

Murakami: Disa njerëz e përmendnin këtë, e dini. Por, e kam sajuar unë. Kam sajuar shumë gjëra.

Treisman: Është fikcion, mund t'i sajoni, por çka nëse është e vërtetë? Nëse e dimë se ju pëlqejnë macet, ta zëmë, a na mundëson kjo që ta kuptojmë më mirë krijimtarinë tuaj?

Murakami: Pyeteni gruan time!


Treisman: A e kupton ajo më mirë krijimtarinë tuaj sepse ju njeh?

Murakami: Nuk e di. Ajo thotë se nuk jam shkrimtari i saj i preferuar, por gjithnjë e kritikon shumë seriozisht krijimtarinë time. Ajo është lexuesja ime e parë, andaj kur përfundoj të shkruarit, ia dorëzoj dorëshkrimin gruas, ajo e lexon dhe ma kthen draftin me dyqind ndërhyrje. I urrej fort ato ndërhyrje. Në fund më thotë: "Duhet t'i rishkruash këto pjesë!"

Treisman: Nëse ju thotë rishkruajini, a i rishkruani?

Murakami: Po, dhe pastaj ia kthej asaj, dhe kësaj here, ajo ma kthen me njëqind vërejtje. Më pak vërejtje. Shenjë e mirë.

(Marrë nga numri i pestë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")



Shkrimtari rus Stalinit: Me mua sillen si me ujkun

Janë bërë publike letrat që Bulgakov i ka shkruar Stalinit. Në një prej tyre ai i shkruante si më poshtë: Shumë i nderuar! "Po forcohet gjithnjë e më tepër tek unë dëshira për të qenë një shkrimtar i kohës sime. Veçse nga ana tjetër kam vënë re se, duke përshkruar të tanishmen nuk po mundem që të vihen në gjendje qetësie dhe kthjelltësie shpirtërore që do të ishte e domosdoshme për të jetësuar një punë të gjerë dhe të strukturuar mirë.

E tashmja është shumë e gjallë, tepër në lëvizje, nxitëse së tepërmi: pena e shkrimtarit, si pa e kuptuar shkon drejt satirës. ...kam menduar shumë të përballoj në jetë një flijim të madh, që të formohem jashtë atdheut tim, bash për ti shërbyer atij. E dija që ky udhëtim nuk do të bëhej për kënaqësinë e të parit të vendeve të huaja, veçse për të vuajtur, si i mbërthyer nga parandjenja se do ta njihja vlerën e njëmendtë të Ruisë vetëm jashtë Ruisë dhe do të mundja ta doja atë, kështu, vetëm larg saj". Ju lutem nxehtësisht që të ndërhyri për mua pranë Qeverisë së BRSS-së që të më jepet leja që të dal jashtë, ndërmjet 1 korrikut dhe 1 tetorit 1931.

Shtoj se, pas një viti e gjysmë heshtjeje, me një vrull të ri do të ndizen projektet e mia krijuese, projekte të gjera dhe të shëndosha dhe i kërkoj Qeverisë që të më japë mundësinë që ti zhvilloj. Që nga mbarimi i 1930-të jam duke vuajtur nga një formë e rëndë neurastenie, me goditje frike dhe ankthi dhe tani jam i mbaruar. Kam projekte, por më mungojnë forcat fizike dhe

kushtet e nevojshme për të punuar.

Shkaku i sëmundjes sime më është bërë i njohur saktësisht. Në arenën e gjerë të letërsisë ruse, në BRSS, unë isha ujk i vetëm. Më këshilluan të ngjyeja lëkurën. Këshillë marroqe. Qoftë e lyer, qoftë i qeshur, një ujk nuk i ngjan kurrë deles. Me mua janë sjellë si më ujkun. Prej vitesh më kanë mbyllur në një oborr të rrethuar, sipas rregullave të akuariumit letrar. Nuk mbaj mëri, por i molisur nga lodhja, në fundin e 1929, u shemba. Edhe një bishë mund të lodhet. Bisha thirri se nuk ishte më ujk, se nuk ishte më një letrar.

Mohoi profesionin e vetë. Heshti. Kjo, le ta themi hapur është dobësi. Nuk ka shkrimtar të vetëm të heshtë. Nëse hesht, kjo do të thotë se nuk është shkrimtar i vërtetë. Nëse një shkrimtar i vërtetë heshtë atëherë kjo do të thotë se ka ardhur fundi. Shkaku i sëmundjes sime është përndjekja e përvitshme, si edhe heshtja. Gjatë këtij viti të fundit kam bërë këto punë: me gjithë vështirësitë e shumta, kam shëndërruar poemën e Gogolit "Shpirtra të



vdekur" në një vepër teatrore. Kam punuar në cilësinë e regjisorit të MCHT në provat e kësaj shfaqjeje, kam punuar si aktor, duke zëvendësuar aktorët e sëmurë në provat, jam emëruar nga MCHT si regjisor për të gjitha fushatat dhe solemnitetin revolucionar të këtij viti, u bëra pjesëtar i TRAM-it të Moskës, duke i shtruar, kështu punës së përditshme të MCHT, atë të natës në TRAM, lashë TRAM-in më 15.3.1931, kur kuptova që truri im e ndaloi ritmin e ecjes dhe s'mund të përballoja dot më TRAM-in, iu përkushtova vënies në skenë për teatrin Sanprosvetit. Dhe natën fillova të shkruaj.

Por u lodha. Jam i këputur. Tani të gjitha ndijimet e mia janë mono-

tone, të gjitha projektet e mia të veshura në të zezë, jam helmuar nga ankthi dhe nga ironia ime e zakonshme... Para se t'ju shkruaj jam menduar thellë. Është e nevojshme për mua të shoh botën dhe pasi ta kem parë të kthehem. Këtu është çelësi i zgjidhjes...

Ju njoftoj Josif Visarionovic se jam në dijeni seriozisht nga personalitete të shquara të mjediseve artistike, të cilët kanë pas udhëtuar jashtë, se do të ishte e pamundur të qëndroja anej. Më kanë thënë se në rast se Qeveria do të hapë dyert për mua, unë duhet të jem i vëmendshëm, sidomos të mos e mbyll vrullshëm prapa meje këtë portë dhe të mos e ndërpres vetë udhën e kthimit, duke i sjellë vetes

telashe edhe më të mëdha nga ato të ndalimit të veprave të mia teatrore.

Sipas opinionit të përgjithshëm të gjithë atyre që janë interesuar për punën time, unë nuk mund të ekzistoj në asnjë vend tjetër veçse në BRSS-së, sepse për 11 vite kam thithur nga ky vend, frymëzimin tim. Sigurisht jam i ndjeshëm nga këto paralajmërime, por më i rëndësishmi akoma i gruas sime, që ka qenë jashtë: ajo më ka thënë se në një vend të jashtëm nuk ka aspak ndërmend të vendoset dhe se unë vetë, atje tej do të vdisja nga malli brenda një viti...

M.Bulgakov
30.5.1931

Historia e kafenesë që frekuentonte Sartri

Café de Flore është nga kafenetë më të vjetra në Paris e hapur që në vitin 1887. Nga fundi i shekullit XIX ishin Charles Maurras apo arvanitasi Moréas që e frekuentonin shpesh. Më 1913-n ishin Apollinaire dhe poeti tjetër Salmon, ata që adhurorin Moréas, të cilët një mjedis të kësaj kafeneje e kishin kthyer në një lloj redaksie ku hartonin lëndën letrare të revistës Les soirées de Paris. Në vitet 1930 gjeje aty Trockin apo studentin e ri kinez Cu En Lai. Në vitin 1939, Sartre dhe Beauvoir e kishin bërë këtë kafene si një shtëpi të dytë. Ja çfarë shkruante Sartre: "Ne u instaluam atje plotësisht. Punonim nga ora nëntë e mëngjesit deri në drekë. Pastaj shkonim të drekonim dhe ktheheshim për t'u takuar me miqtë tanë, me të cilët bisedonim deri në orën tetë të mbrëmjes. Pas darkës takonim ata me të cilët kishim lënë aty të takoheshim.

Mund të duket e çuditshme, por te Flore ne ishim si në shtëpinë tonë...". Nga vitet '40 - '50 mbledheshin aty Robert Desnos, George Bataille, Giacometti, Queneau apo Picasso dhe piktori Zadkin etj. Café de Flore gumëzhinte nga intelektualët, artistët, një periudhë nga ekzistencialistët, Camus që diskutonte me zjarr me Beauvoir apo Sartre, Jacques Prevert, Boris Vian apo Juliette Greco, letrarë e artistë të skenës, muzikës, aktorë si Yves Montand, Simon Signoret, Belmondo etj., por dhe aktorë e regjisorë të ardhur nga Amerika si Orson Wells, Marlène Dietrich, Jane Fonda, Jane Seberg ... Edhe sot, kjo kafene ka mbetur një kafene elite dhe mjaft e lulëzuar, aq sa nga larg të duket sikur ke të bësh me ndonjë dyqan lulesh. Veç salloneve poshtë, kati lart është më i qetë dhe intim. Në Flore, ngjitur me librarinë e njohur filozofike Hume, takimet janë të këndshme.



E jashtëzakonshme

Krijohet portreti i Da Vinçit në 27 kilometra katrorë tokë

Një artist italian ka përkujtuar 500-vjetorin e vdekjes së Leonardo da Vinçit duke krijuar portretin e tij në një arë. Dario Gambarin përdori një traktor për t'i ravijëzuar linjat dhe vijat duke formuar një imazh 27 kilometra katrorë të fytyrës së Da Vinçit, në fermën e prindërve të tij në Verona të Italisë. Gambarinit,



i quajtur ndryshe 'artisti i tokës', iu deshën tetë orë për ta përfunduar punën.

FOTO E DITES



Garë me biçikleta në rërën e Marokut. /AFP/

E rrallë

Gjesti i veçantë, vajza e vogël dhuron 3 euro për Notre Dame

Jo vetëm të pasurit dhe të fuqishmit po dhurojnë para për rindërtimin e Notre Dame, pasi zjarri shkatërroi katedralen e Parisit këtë muaj. Një pjesë shumë e vogël, gati 850 milionë euro të dhuruara deri tani, vijnë nga një burim



shumë modest. Një vajzë e vogël nga Britania dërgoi 3.38 euro në Fondation du Patrimoine, një nga katër organizatat e ngarkuara nga qeveria franceze për mbledhjen e donacioneve për rindërtimin e katedrales.

BARSOLETA E DITËS



Telefonata e çuditshme
Tëksa një çift po drekonte në kuzhinë, bie telefoni.
Përgjigjet burri:
- Alo! Po? E nga ta di unë? Telefoni policisë rrugore!
Gruaja e pyet se kush ishte, e burri i përgjigjet:
- As që e kam idenë... Më pyeste nëse rruja ishte e lirë...



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

“THE KID WHO WOULD BE KING”

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

“CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

“U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award®-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Kritikat e bëra ndaj jush po japin


rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë me të mirën prej tyre dhe e keni vënë në zbatim.



DEMI

Keni kuptuar që jeta është e përbërë

edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po u dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.



BINJAKËT

Iniciativat që do të ndërmerri sot do t'u

japin shumë zgjidhje personave afër jush. Dikush do t'ju shprehë falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.



GAFORRJA

Një problem konstant që nuk po

ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.



LUANI

Sot keni vënë në dukje një anë të

panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.



VIRGJËRËSHA

Dikush do të kërkojë sqarime

nga ju se përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur.



PESHORJA

Këtë periudhë keni

zgjedhur një mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes suaj dhe injorimit të personave të caktuar.



AKREPI

Keni bërë ç'është e mundur për t'i

sqaruar gjërat me një person të caktuar, por përsëri ju kanë keqkuptuar. Mbase mungon qasja nga pala tjetër.



SHIGJETARI

Sot mund t'ju lindin probleme me famil-

jarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.



BRICJAPI

Ua keni dhënë hapësirën e duhur

personave të duhur, por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do ta keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.



UJORI

Të ecni përpara në

karrierën tuaj në këto momente paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.




PESHQIT

Sot doni ta

ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet ta merrni edhe mendimin e të tjerëve.

Modeli 26-vjeçar rrëzohet dhe vdes gjatë Javës së Modës në Brazil



Një model 26-vjeçar ka vdekur pasi u rrëzua në skenë gjatë një sfilate të modës. Tales Soares u rrëzua gjatë Javës së Modës në Sao Paulo të Brazilit. Qindra anëtarë të audiencës, fillimisht supozonin se incidenti ishte pjesë e

shfaqjes, por Soares shpejt filloi të shkumonte nga goja dhe ekipet emergjente erdhën shpejt për ta ndihmuar. Mjekët nuk patën mundësi ta ringjallnin atë. Modeli 26-vjeçar u dërgua edhe në spital, e aty u konstatua se ka vdekur.

Kate Hudson shkëlqen sërish



Aktorja e famshme Kate Hudson të dielën në mbrëmje ka dalë në një darkë romantike në Los Angeles, me të dashurin e saj Danny Fujikawa. Hudson dukej

shumë bukur në atë takim, ajo pati të veshur pantallona dhe një bluzë të bardhë që i rrinte shumë bukur. Para gjashtë muajve ajo ka lindur një vajzë.



Alessandra Ambrosio nuk i ndahet të dashurit

Alessandra Ambrosio dhe i dashuri i saj Nicolò Oddi janë parë në një restorant gjatë fundjavës që lamë pas në Santa Monica në Kaliforni. Modeluesja 38-vjeçare e "Victoria's Secret" kishte të veshur

xhinse të kombinuara me një xhakete të zezë, ndërkaq i dashuri i saj një bluzë me ngjyra. Në fillim të këtij muaji, Alessandra dhe Nicolò janë parë bashkë me miqtë e tyre duke shëtitur në Festivalin e Muzikës Coachella 2019.


88-vjeçarja kubane, në turin muzikor të lamtumirës



Në moshën 88-vjeçare, Omara Portuondo, është një legjendë muzikore që ende shëtit nëpër botë me muzikën e saj. Këngëtarja e grupit të njohur kuban "Buena Vista Social Club" po jep turneun botëror të lamtumirës, "Puthja e fundit", me të cilin u ndal në Nju Jork. Kanë kaluar

më shumë se 20 vjet qëkur një grup këngëtarësh u mblodhën së bashku në Havana për ta ringjallur muzikën e para revolucionit. "Buena Vista Social Club" u bënë të njohur në mes të viteve '90-ta, fituan një çmim "Grammy" dhe shitën miliona kopje albumesh në të gjithë botën.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Feronikeli dhe Prishtina ua 'mbyllin' gojën lojtarëve, Llapi jo



Feronikeli dhe Prishtina tashmë ua kanë "mbyllur" gojën futbollistëve që mos të deklarohen për medie, kurse Llapi po e bën të kundërtën e tyre. Trajneri Tahir Batatina vlerëson se një gjë e tillë është e papranueshme për faktin se janë futbollistët ata që derdhin djersë në fushë. "Normalisht se iu lejohet sepse futbolli nuk luhet pa deklarata. Mua si trajner aspak nuk më pengon që futbollistët japin mendimin e tyre, pasi ata derdhin djersë dhe është e padrejtë që t'u ndalohet një gjë e tillë", ka thënë Batatina

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 PRILL - Kampionati 2018/2019 është në fazën e fundit dhe përfundon vetëm edhe katër xhiro, kurse dy skuadrat që janë duke luftuar për titull të kampionit, Feronikeli dhe Prishtina, kanë marrë masa edhe ndaj lojtarëve që mos të deklarohen për medie. Në fakt, e para ishte skuadra nga kryeqyteti që kishte bërë një gjë të tillë. Futbollistët "bardhekaltër" thua-jse gjatë gjithë kampionatit nuk kanë pasur të drejtë të deklarohen për medie, kurse rrugën e Prishtinës e ka ndjekur edhe Feronikeli. Kjo e fundit, sidomos pas dështimit në ndeshjen ndaj Ballkanit, ka marrë disa masa ku vlen të ceket edhe paralajmërimi i kryetarit të klubit, Naser Rama, se do të

ketë dënime pas humbjes së pësuar. "Është shumë marre për ju. Jam i zhgënjyer në ju sa me mend s'mund ta merrni. Ju jeni zhgënjimi im më i madhi deri tash. Do t'i merrni dënimet e merituar", kishte shkruar Ramaj. Gazeta të hënën ka kontaktuar dy futbollistët të skuadrës nga Drenasi, por të cilët nuk ishin në gjendje të deklarohen për shkak se kryesia e klubit ua ka kumtuar vendimin që mos të japin deklarata për medie. "Na vjen keq, por është vendim i klubit që mos të deklarohemi për medie", kanë qenë përgjigjet e shkurtra të futbollistëve të "Niklit".

Shembullin e Prishtinës dhe Feronikelit nuk e ka ndjekur Llapi, pasi futbollistët e kësaj skuadre kanë të drejtën ta japin mendimin e tyre në lidhje me rrjedhën e kampionatit, synimet individuale apo

synimet me klubin. Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka thënë për "Epokën e re" se nuk i pengon aspak që futbollistët e tij të deklarohen për medie, madje ai e konsideron se mohimi është shumë i padrejtë ndaj futbollistëve. "Normalisht se iu lejohet sepse futbolli nuk luhet pa deklarata. Mua si trajner aspak nuk më pengon që futbollistët ta japin mendimin e tyre, pasi ata derdhin djersë dhe është e padrejtë që t'u ndalohet një gjë e tillë", ka thënë Batatina.

Feronikeli, Prishtina dhe Llapi janë në garë të rreptë për titull të kampionit në këtë edicion, kurse dallimi mes skuadrës së Batatinës me dy skuadrat e para është vetëm dy pikë, por titulli mund të vendoset pikërisht në përballjet e drejtpërdrejta që kanë këto skuadra në këto xhiro të mbetura.

SHKURT

Vëllaznimi pezullon futbollistin Almedin Murati

Bordi i KF Vëllaznimi nga Gjakova e ka pezulluar futbollistin e njohur Almedin Murati i cili kishte bërë sjellje jospportive në ndeshjen ndaj Vitisë (1-1). "Bordi i Klubit të Futbollit 'Vëllaznimi' ka analizuar sjelljen e futbollistit Almedin Murati. Duke e vlerësuar sjelljen e tij karshi publikut pas zëvendësimit, Bordi i Klubit, në përputhje me Rregulloren Disiplinore, ka marrë vendim që Almedin Murati të pezullohet për kohësisht deri në marrjen e vendimit definitiv", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vëllaznimit. Skuadra kuqezi nga Gjakova është duke luftuar për inkuadrim në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

Prishtina - Rahoveci, finalja në elitën e basketbollit

Në ndeshjen e tretë gjysmëfinale, skuadra e Rahovecit, e përkrahur nga tifozët e saj 'Vreshtarët', u kualifikua në finale, duke e mposhtur Golden Eagle Yllin me rezultat 84:70. Te Rahoveci basketbollistët më efikas ishin Richardson me 35 pikë, Qallaku me 18, ndërsa te Golden Eagle Ylli më të dalluarit ishin Osby me 22 pikë dhe Veseli me 19 pikë. Në finale do të takohen Z Mobile Prishtina dhe Rahoveci.

FBK-ja shpërblet KBF Prishtina me 4 000 euro

Skuadra kampione në Ligën e Femrave, KBF Prishtina, do të shpërblehet nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) me shumën 4 000 euro, do të thotë me dy mijë euro më shumë se në dy vjetet e mëparshëm. FBK-ja do të vazhdojë t'i shpërblejë edhe klubet e Superligës së Kosovës për rezultatet e arritura në edicionin 2018/19. Në këtë mënyrë skuadra kampione e elitës së basketbollit kosovar do të shpërblehet me 12 000 euro, ndërsa ekipit nënkampion do t'i takojnë 6 000 euro. Ndërkaq skuadrat që kanë arritur të sigurojnë nga një vend në katërshen e madhe të elitës së basketbollit kosovar do të shpërblehen me nga 3 000 euro. Në këtë mënyrë, krahas të hollave nga të drejtat televizive që u ndahen klubeve të Superligës së Kosovës, Bordi i FBK-së vazhdon t'i mbështesë skuadrat e elitës së meshkujve dhe femrave për t'i inkurajuar dhe për t'i ndihmuar sadopak për mbulimin e shpenzimeve.

Lala: Rashica ka tërhequr vëmendjen e klubeve të mëdha në Evropë

TIRANË, 29 PRILL - Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Altin Lala, që ka qenë mbështetësi kryesor i Milot Rashicës në karrierën ndërkombëtare, ka thënë se ylli i Kosovës ka tërhequr

vëmendjen e shumë klubeve të mëdha në Evropë. "Futbolli është bërë shumë i shpejtë, Miloti ka tërhequr vëmendjen e klubeve të mëdha në Evropë. Ai duhet të përmirësohet në disa

aspekte për ta arritur nivelin më të lartë. A mund të ketë lëvizje? Nuk mund ta them 100%. Futbolli është i paparashikueshëm, por edhe në Bremen ai ndihet shumë

mirë dhe do të ishte mirë që të luante edhe një sezon. Klubet shohin shumë potencial te Miloti dhe shpresojmë se një ditë të arrijë majat", ka deklaruar Lala për "Supersport".



Futbolli turk në zi, aksidenti i merr jetën lojtarit çek

ALANYA, 29 PRILL - Tragjedi e rëndë në futbollin turk. Mbrëmjen e së dielës një minibus, që kishte në bord shtatë lojtarë të skuadrës së Superligës turke Alanyaspor, ka pësuar një aksident tragjik, në të cilin ka humbur jetën futbollisti i kombëtares çeke, Josef Sural. Në

minibus ishte edhe ish-sulmuesi i Newcastle United dhe përfaqësueses së Senegalit, Papiss Cisse, i cili, bashkë me pesë lojtarët e tjerë, janë jashtë rrezikut për jetën.

Sural, 28 vjeç, u transportua me urgjencë drejt spitalit më të afërt,

por nuk arriti t'u mbijetonte plagëve të marra. Sipas asaj që ka thënë presidenti i klubit, duket se aksidenti ka ardhur si pasojë e përgjumjes së shoferit. Futbollistët po ktheheshin në Alania, pas transferimit që kishin ndaj Kayserisporit, me një

minibus të marrë me qira. Josef Sural ishte transferuar tek Antalyaspor vetëm në janar të këtij viti nga Sparta e Pragës, por aventura e tij e parë jashtë Çekisë zgjati vetëm pak muaj dhe përfundoi në mënyrën më tragjike të mundshme.



Sonte përballja Tottenham - Ajax

LONDËR, 29 PRILL (ER) - Tri ndeshje janë larg për të triumfuar në garën e Ligës së Kampionëve, Tottenham Hotspur dhe Ajaxi. Këto dy klube i kanë tejkaluar parashikimet duke arritur të kualifikohen deri në gjysmëfinale të garës më të fortë në futboll, kurse sonte nga ora 21:00 në "Tottenham Hotspur Stadium" e zhvillojnë përballjen e parë mes vete. "Spurs" u kualifikua pasi e mposhti Manchester Cityn në ndeshjen e parë 1-0 dhe humbi në ndeshjen e dytë 4-3.

Në anën tjetër, Ajaxi pati paraqitje shumë të mirë, ku fillimisht eliminoi Real Madridin e më pas edhe Juventusin. Skuadra holandeze është gati të vazhdojë me befasi edhe ndaj anglezëve të Tottenhamit. Gjysmëfinalja tjetër është në mes të Liverpoolit dhe Barcelonës, por një gjë është e sigurt, se në finale do të jetë një skuadër jofavorite. Derisa Tottenhami në ndeshjen e fundjavës në Premierë Ligë pësoi humbje nga West Ham United (0-1), kurse Federata e Futbollit të Holandës e ka shtyrë një xhiro të kampionatit, me qëllim për ta ndihmuar skuadrën e Ajaxit. Trajneri Pochettino nuk do të ketë në dispozicion sulmuesit Harry Kane dhe Heung-Min Son, por në vend të tyre mund të luajnë Lucas Moura dhe Fernando Llorente. Në dyshim



FORMACIONET E MUNDSHME

Tottenham: Lloris, Trippier, Alderweireld, Vertonghen, Davies, Wanyama, Dier, Rose, Eriksen, Dele Alli, Lucas Moura.

Ajax: Onana, Veltman, Blind, De Ligt, Mazraoui, Shone, De Jong, Ziyech, Van Beek, Neres, Tadiq.

janë Moussa Sissoko, Harry Winks, Erik Lamela dhe Serge Aurier. Në anën tjetër, Ajaxit pritet t'i mungojnë

një Nicolas Tagliafico dhe Carel Eiting, kurse i gatshëm është Noussair Mazraoui.

Duranti fiton betejën me Hardenin, Celticsi, i fortë për Bucksin

MILWAUKEE, 29 PRILL - Kevin Durant dhe James Hardeni kanë shënuar nga 35 pikë dhe në fund ka festuar Golden State Warriors me rezultatin 104-100 ndaj Houston Rocketsit. Kampionët në fuqi bënë më mirë në periodën e parë dhe të tretë, ndërkohë që në këtë fitore dhanë një ndihmë të madhe edhe Stephen Curry (18 pikë, 4 asistime, 7 rebounde) dhe Draymond Green (14 pikë, 9 asistime, 9 rebounde). Nga ana tjetër, edhe Chris Pauli (17 pikë, 4 asistime, 3 rebounde) dhe Eric Gordon (27 pikë, 4 rebounde) u munduan ta ndihmojnë James Hardenin, por pa sukses. Milwaukee Bucks-Boston Celtics është një sfidë mjaft interesante që ka nisur me fitoren e miqve me rezultatin 90-112. Celticsi dominoi pjesën më të madhe të ndeshjes dhe kështu e kaluan me sukses gjysmëfinalen e parë të Konferencës së Lindjes. Kyrie Irving ishte njeriu i ndeshjes, teksa shënoi 26 pikë, dha 11 asistime si dhe rikuperoi 7 topa në



tabelë. Al Horford dhe Jaylen Brown, autorë të 20 dhe 19 pikëve, dhanë një kontribut të rëndësishëm në fitoren e Celticsit. Pritej shumë nga Giannis Antetokounmpo i Bucksit. Ai u

ndal në 22 pikë, 2 asistime dhe 8 topa të rikuperuar në tabelë. Khris Middleton (16 pikë, 6 asistime, 10 rebounde) ishte krahu i djathtë i grekut. Gjithsesi, Bucks i ka nisur gjysmëfinalen me humbje.

REZULTATET

| | | |
|-----------------------------------------|---------|-------|
| Milwaukee Bucks - Boston Celtics | 90-112 | (0-1) |
| Golden State Warriors - Houston Rockets | 104-100 | (1-0) |

SHKURT

Zidane: Humbje e turpshme, kërkoj falje

Real Madridi pësoi humbje nga Rayo Vallecano (1-0), kurse kjo e ka nervozuar përtej mase trajnerin Zinedine Zidane. Strategu francez ka thënë se një paraqitje e tillë nuk i lejohej një skuadre siç është Real Madridi. "Nuk bëmë asgjë, nuk luajtëm futboll fare, asnjë tentativë për të shënuar. Jam shumë i zemëruar, sepse një imazh i tillë nuk i lejohej një skuadre si Reali. Duhet të kërkojmë falje. Do ishte mirë që sezoni të mbaronte sa më shpejt", ka thënë Zidane.

Van Dijk, mbrojtësi i vitit në Premierë Ligë

Mbrojtësi i Liverpoolit, Virgil van Dijk, është shpallur lojtari më i mirë i vitit në Premierë Ligë, ndërsa ylli i Manchester Cityt, Raheem Sterling, ka marrë çmimin për futbollistin më të mirë të ri. Qendërmbrojtësi holandez është paraqitur në të gjitha ndeshjet e Liverpoolit në ligë këtë sezon, duke ndihmuar "Të kuqtë" ta mbajnë portën e paprekur në 19 paraqitje. "Mendoj se është vlerësimi më i madh që mund t'u bëhet si lojtar që merr vota nga lojtarët e tjerë me të cilët luan çdo javë", ka thënë ai. Holandezi iu bashkua Liverpoolit në janar të vitit 2018 për 75 milionë funte nga Southamptoni. Liverpooli këtë sezon është i dyti, me 36 ndeshje të zhvilluara, duke pësuar vetëm një humbje. Van Dijk është vetëm mbrojtësi i tretë që e merr këtë çmim.

Hazardi konfirmon marrëveshjen me Dortmundin

Futbollisti i Borussia Monchengladbachut, Thorgan Hazard, ka konfirmuar lajmin se ka arritur marrëveshje me skuadrën tjetër nga Bundesliga, Borussia Dortmund. "Kam një marrëveshje me Borussia Dortmundin. Kam biseduar me të dhe kemi mbyllur gjithçka. Tani është në dorë të klubeve për ta mbyllur transferimin", ka thënë futbollisti belg. Interesim për sulmuesin 26-vjeçar kishte edhe nga skuadrat e Premierë Ligës, kurse ai ka luajtur edhe për Lensin dhe Zulte Waregem.

Gattuso: Jemi duke e turpëruar këtë klub historik

Trajneri i Milanit, Gennaro Gattuso, ka hedhur kritika në drejtim të skuadrës së tij pas humbjes 2-0 nga Torino, disfatë kjo që e lë Milanin në pozitën e shtatë në tabelë, derisa vihen në rrezik edhe gjasat për një pozitë që dërgon në Ligën e Kampionëve. "Ne jemi duke bërë më pak qejf sesa para dy muajsh dhe kjo po lë gjurmë. Ne nuk jemi të shkathtë, ne mendojmë shumë dhe kjo e ul entuziazmin. Kjo është arsyeja pse them se nuk mund të hyjë në kokat e lojtarëve sepse duam që ata ta kenë syrin e tigrin, një kurajë të vazhdueshme dhe vendosmëri, por kjo nuk është duke ndodhur. Ne vetëm jemi duke marrë rezultate turpëruese për skuadrën tonë. Ne jemi duke e turpëruar këtë klub historik", ka thënë Gattuso.

"Sport": Barça, favorite për transferimin e De Ligit

Matthijs De Ligt është aktualisht një prej futbollistëve më të kërkuar në botë para rihapjes së afatit kalimtar të verës. Qendërmbrojtësi i Ajax Amsterdamt ka shkëlqyer me paraqitjet e tij gjatë këtij sezoni duke zgjuar interesim nga klube të mëdha evropiane, përfshirë Barcelonën, Manchester Cityn dhe Juventusin. Por, e përditshmja sportive katalane "Sport" raporton se Barcelona është favorite e re për transferimin e tij. De Ligt thuhet se preferon t'i bashkohet shokut të tij nga Ajax, Frenkie de Jong, i cili tashmë ka zyrtarizuar transferimin në "Camp Nou" për sezonin e ri.


UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"

 Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 Gjakovë, Republika e Kosovës
 Tel: 038 200 20 831 Web: www.uni-gjk.org E-mail: rektorati@uni-gjk.org

 Nr. Prot.: 01/95
 Datë 26/04/2019

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, Udhëzimit Administrativ 7/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe nenit 48 paragrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Senati UGJFA-së në mbledhjen e mbajtur me datë 11.03.2019, mori vendim për të shpallur:

KONKURS

për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Gjakovës

I. FAKULTETI I EDUKIMIT
Programet: Edukimi Parashkollor dhe Edukimi Fillor

- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe I dhe II (Programi Parashkollor dhe Fillor).
- Një (1) mësimdhënës për grup lëndësh nga: Matematika (Programi Parashkollor dhe Fillor).
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II (Programi Parashkollor dhe Fillor).
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Filozofi e edukimit, Teori e mësimin, Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji dhe Bazat e hulumtimit në edukim (Programi Fillor).
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Bazat e shkencave natyrore me metodologji I dhe II (Programi Fillor dhe Parashkollor).

II. FAKULTETI I MJEKËSISË
Programet: Infermieri dhe Mami

- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Bazat e mjekësisë klinike dhe ndihma e parë, Kujdesi Infermior I, Infermieri Geriatrike dhe Rehabilitimi dhe Kujdesi Infermior në raste kritike
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Shëndet Publik me Epidemiologji dhe Nutricion, Mbrojtja e Shëndetit, Sociologjia e Shëndetit dhe e Sëmundjes, Organizimi dhe Menaxhimi në Infermieri
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Kujdesi Infermior II. Kujdesi për fëmijët e sëmurë dhe Perspektiva e kujdesit mjekësor
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Kujdesi Infermior tek pacientët internistik, Infermieri Geriatrike dhe Rehabilitimi dhe Kujdesi paliativ
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Mami në kontekstin psikosocial, Psikologjia në Infermieri dhe Reanimimi KardioPulmonar.

III. Kushtet e përgjithshme

- Zgjedhja e personelit akademik do të behet në pajtim me dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Udhëzimit Administrativ (MPMS) 7/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe vendimin e Senatit të UGJFA-së nr. 01/160/1 të dt. 28.02.2018.
- Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet t'i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 157 paragrafi 1 të Statutit të përkohshëm të UGJFA-së, dhe atë:
 - të kenë gradën e doktorit të shkencës
 - të kenë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore, me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare
 - të tregojnë aftësi për mësimdhënie
 - të kenë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet.

IV. Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - kërkesën për aplikim dhe biografinë (CV)
 - certifikatën e lindjes (origjinale) jo më të vjetër se 6 muaj dhe kopjen e letërnjoftimit
 - diplomat origjinale ose kopjet e diplomave përkatëse (për pozitën e mësimdhënësit diploma e tri niveleve të studimeve, ndërsa për pozitën e asistentit diploma për dy nivelet e studimit dhe pasqyrën e notave) të vërtetuara nga noteri
 - kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit duhet të sjellin edhe vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse (baçelor, master, magistraturë, doktoratë). Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim
 - dëshmitë për monografitë dhe publikimet shkencore e profesionale në revista ndërkombëtare shkencore brenda kornizës së përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 1/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension (e plotësuar me Udhëzimin Administrativ 7/2018) dhe vendimin e Senatit të UGJFA-së nr. 01/160/1 të datës 28.02.2018

- dëshmi nga organet kompetente që nuk janë në hetime ose nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale (origjinale)
- dëshmi mbi përvojën e punës në mësimdhënie
- si dhe informata tjera shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

- Kandidatët të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës duhet t'i paraqesin edhe këto dokumente shtesë:
 - leje qëndrimin apo lejen e punës në Republikën e Kosovës (të noterizuar)
 - dëshmi origjinale nga institucioni relevant në vendin e origjinës (p.sh Administrata Tatimore) që nuk kanë marrëdhënie të rregullt të punës në vendin e tyre të origjinës.

V. Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim


- Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës.
- Në Universitetin e Gjakovës nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjë prej njësisë akademike (fakulteteve), nëse brenda të njëjtës njësi akademike kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjar të ngushtë.
- Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

VI. Vendimi, periudha e ankimit dhe e përmblyljes së konkursit


- Kandidatët të cilët janë të pakënaqur me vendimet e organeve kompetente të njësisë akademike, përkatësisht Senatit të UGJFA-së, gjatë procesit të përzgjedhjes së personelit akademik, kanë të drejtë ankese në dy faza:
 - Faza e parë e ankimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të Buletinit në ueb-faqe të UGJFA-së. Buletini do të qëndrojë i publikuar 15 ditë në ueb-faqe të UGJFA-së. Ankesa duhet të dorëzohet në njësinë akademike përkatëse dhe do të shqyrtohet nga këshilli i njësisë akademike brenda 15 ditësh nga dita e përmblyljes së afatit të ankimit. Raporti përfundimtar pas shqyrtimit të ankesave i dërgohet për njoftim Komisionit të Studimeve lidhur me rregullsinë e procedurës dhe propozimeve nga fakultetet.
 - Faza e dytë e ankimit bëhet ndaj vendimit të Senatit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit në dorëzim të vendimit. Ankesa duhet t'i drejtohet Komisionit të Senatit për ankesa dhe parashtesa, që shërben si instancë e fundit e ankimit në UGJFA. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante dhe arsyeshmërinë e kontestimit të vendimit. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i ankesave i prezantohet Senatit për vendosje përfundimtare në nivel të UGJFA-së. Propozimi i Komisionit të Senatit për ankesa dhe parashtesa nuk ka karakter obligativ për Senatit.
- Pala ankuese do të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin përfundimtar të Senatit.
- Konkursi për emërim të personelit akademik, duhet të përmbillet me vendime përkatëse të Senatit të UGJFA-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
- Për raste të veçanta, para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimum për 30 ditë.

VII. Mënyra e aplikimit


- Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë fizike dhe elektronike (CD);
- Dokumentacioni në formë fizike dhe elektronike (CD) duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës, përkatësisht për:
 - Fakultetin e Edukimit në adresën "Normalja e Gjakovës" pn., 50000 Gjakovë
 - Fakultetin e Mjekësisë në adresën "Mit'hat Frashëri" pn., 50000 Gjakovë
- Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tersi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
- Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike (me CD), nuk do të merren në shqyrtim.
- Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, përkatësisht nga data 30.04.2019 deri më datën 14.05.2019.
- Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në adresën: <http://www.uni-gjk.org>
- Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Administratën e Fakulteteve përkatëse, prej orës 09:00 – 16:00
 - për Fakultetin e Edukimit në numrin e tel: 038 200 20 835
 - për Fakultetin e Mjekësisë në numrin e tel: 038 200 20 849.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



QKMF- „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
GCPM „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
MCFM „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
Nr.182/2019
Datë:26.04.2019




Kuvendi i Komunës
Skupština Opštine
Municipal Assembly

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212,Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin public,Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare bënë :

SHPALLJEN E REKRUTIMIT

**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
TITULLI I VENDIT TË PUNËS: INFERMIERI E PËRGJITHSHME- 6 (gjashtë pozita)**

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Koefficienti: H-377
Numri i referencës së vendit të punës:182/2019
Detyrat dhe përgjegjësitë:
Ofron kujdesin shëndetësor ndaj pacientëve në institucionet shëndetësore.
Mbledhë të dhënat e sakta për pacientët.
Të kryen të gjitha punët e infermierisë,që kërkohen nga shefi i njësisë,Kryeinfermieri-ja,Drejtori.
Raporton për punën e saj të shefi i njësisë dhe Kryeinfermieri-ja.
Bashkëpunon me anëtarët tjerë të ekipit mjekësor etj.
Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm,si dhe ekzistues.
Kushtet e konkursit:
Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende,përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj,duhet t,i plotësojnë edhe kushtet e veçanta:
Shkollimi i kërkuar:SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË-DREJTIMI INFERMIERI E PËRGJITHSHME
Afësitë ,përvoja dhetribute të tjera që kërkohen:
Certifikata e licencimit dhe dëshmi të tjera të afësismit
Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe gojë,si dhe njohja e punës me kompjuter.
Përvoja e punës e dëshirueshme.
Kohëzgjatja e emërimit: Sipas ligjit të punës nr.03/L-212.Puna provuese 6 muaj,pastaj me kontratë me afat të pacaktuar,nëse plotësohen kushtet në bazë të ligjit të punës.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.
Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare zyra numër 104,brenda 15 ditëve prej ditës së shpalljes së konkursit në shtyp.
Aplikacionit duhet t,i bashkëngjiten këto dokumente :Kopjen e vërtetuar të Diplomës,dëshmi të përvojës së punës,certifikatën shëndetësore,kopjen e letërnjoftimit,licencën e punës,certifikatën e lindjes,dëshminë se nuk është nën hetim.
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE U SHËRMBEN TË GJITHË BANORËVE TË KOSOVËS DHE MIRËPRET APLIKACIONET NGA FEMRAT DHE MESHKUJT E TË GJITHA KOMUNITETEVE TË KOSOVËS
Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit,nuk do të pranohen.Kërkesat e pakompletuar dhe të cilat nuk janë në përputhje me konkursin do të refuzohen.Për shkak të madh të kërkesave të pranura,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.Për çdo informacion,kandidatët mund të kontaktojnë Drejtorinë e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik.




Njoftim


Njoftojmë të interesuarit se me datën 10 Maj 2019 (E Premte) me fillim në orën 11⁰⁰ Bsc. i dipl. Elbasan S. Shehu mbron punimin e Masterit me titull "Ndikimi i aktivitetit fizik (shëtitja ditore) në disa parametra kuantitativ të farës së demave - Rasti i qendrës për insiminim artificial në Vitomiricë". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.

Njoftim


Njoftojmë të interesuarit se me datën 10 Maj 2019 (E Premte) me fillim në orën 12⁰⁰ Bsc. i dipl. Hamit H. Manaj mbron punimin e Masterit me titull "Ndikimi i aktivitetit fizik (shëtitja ditore) në disa parametra kualitativ të farës së demave - Rasti i qendrës për insiminim artificial në Vitomiricë". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



QKMF- „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
GCPM „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
MCFM „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
Nr.182/2019
Datë:26.04.2019



Komuna Kaçanik
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

U skladu sa članom 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, Administrativno uputstvo br.07 / 2017 o regulisanju procedura za uspostavljanje radnih odnosa u javnom sektoru, Glavni centar za porodičnu zdravilje je:

REKRUTIVNI OGLAS


**GLAVNI PORODIČNI MEDICINSKI CENTAR
NAZIV RADNOG MESTA: OPŠTA MEDICINSKE SESTRE - 6 (šest pozicija)**

Radno mesto: Glavni centar porodične medicine
Koefficienti: H-377
Broj postaja: 182/2019
Dužnosti i odgovornosti:
Pružna zdravstvenu zaštitu pacijentima u zdravstvenim ustanovama.
Prikupite tačne podatke o pacijentu.
Obaviti sve poslove za njegu koje zahtijeva šef jedinice, glavna sestra, direktor.
Izveštava o svom poslu šefu povrede i glavnoj sestri.
Suraduje sa drugim članovima medicinskog tima, itd.
Procedura takmičenja: Natječajna procedura je otvorena za sve vanjske i postojeće kandidate.
Uslovi Oglas :
Kandidati koji se konkurirše za ove poslove, pored opštih uslova predviđenih zakonom, moraju ispunjavati sledeće posebne uslove:
Neophodna edukacija:SREDNJA MEDICINSKA ŠKOLA-SMER OPŠTE MEDICINSKE SESTRE

Potrebne vještine, iskustvo i drugi atributi:
Certifikat o licenci i drugi dokazi o obuci
Imaju dokazane i efikasne vještine pisane i usmene komunikacije, kao i poznavanje rada na računaru.
Poželjno radno iskustvo.
Trajanje imenovanja: U skladu sa Zakonom o radu br. 03 / L-212 Probni period je 6 meseci, zatim na neodređeno vreme ako su ispunjeni uslovi iz Zakona o radu.
Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u javnim medijima.
Obrasci za prijavu: Prijavni obrasci se primaju i dostavljaju u objekat Glavnog centra porodične medicine broj 104, u roku od 15 dana od objavljivanja konkursa za štampu.
Uz prijavu se prilažu sledeća dokumenta: overena kopija diplome, dokaz o radnom iskustvu, zdravstvena potvrda, kopija lične karte, radna dozvola, izvod iz matične knjige rođenih, dokaz da nije pod istragom.

GLAVNI PORODIČNI MEDICINSKI CENTAR KOJI JE SLUŽIO SVIM KOSOVSJKIM STANOVNIKAMA I DOBROPRIJAMA APLIKACIJE OD ŽENE I MUŠKARCE SVIH KOSOVSJKIH ZAJEDNICA


Zahtevi podneti posle poslednjeg datuma neće biti prihvaćeni, a nepotpuni zahtevi koji nisu u skladu sa konkursom biće odbačeni zbog velikog broja pristiglih prijava, samo kandidati koji su ušli u uži izbor Za sve informacije, kandidati se mogu obratiti Direkciji Glavnog centra za porodičnu medicinu u Kačaniku.





>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ O.S. Listeri shpallë të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 80201516.
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

**TOP
PAKO**

 Komunikim **FALAS**

 Internet deri në **50Mbps**

 Televizion Digjital

Për vetëm 17euro

TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

WWW.IPKO.COM

